



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr. 135

17 tetor

2012

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr. 89/2012 datë 27.9.2012	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin “Për përgatitjen, reagimin dhe bashkëpunimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme (OPRC - HNS), 2000”	7679
Ligj nr. 90/2012 datë 27.9.2012	Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore	7695
Ligj nr. 91/2012 datë 27.9.2012	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9109, datë 7.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar	7706
Ligj nr. 92/2012 datë 27.9.2012	Për një ndryshim në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar	7714

LIGJ
Nr. 89/2012

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN “PËR
PËRGATITJEN, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDAJ INCIDENTEVE TË NDOTJES
NGA LËNDËT E RREZIKSHME DHE TË DËMSHME (OPRC - HNS), 2000”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin “Për përgatitjen, reagimin dhe bashkëpunimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme (OPRC - HNS), 2000”, sipas tekstit bashkëlidhur.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7790, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

PROTOKOLLI OPRC-HNS

PROTOKOLLI
PËR PËRGATITJEN, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDAJ INCIDENTEVE TË NDOTJES
NGA LËNDËT E RREZIKSHME DHE TË DËMSHME, 2000

Përfshirë
Aktin përfundimtar të Konferencës OPRC-HNS, 2000
dhe rezolutat e Konferencës

Parathënie

Sipas rezolutës 10, Konferenca e vitit 1990 për Bashkëpunimin Ndërkombëtar për Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Ndotjes nga Nafta, ftoi Organizatën Detare Ndërkombëtare për të filluar punën mbi zhvillimin e instrumentit përkatës për të zgjeruar objektin e Konventës Ndërkombëtare për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990, që do të zbatohet tërësisht ose pjesërisht, ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme përveç naftës dhe përgatitjen e propozimit për këtë qëllim.

Sipas kësaj rezolute, Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar përgatiti dhe, në sesionin e tij të dyzet e katërt në nëntor 1998, miratoi në parim një draft protokoll mbi përgatitjen, reagimin dhe bashkëpunimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme. Së bashku me



Konventën OPRC, Protokollin OPRC-HNS do të paraqesë kuadrin për bashkëpunim ndërkombëtar në përcaktimin e sistemeve për përgatitjen dhe reagimin në nivelet kombëtare, rajonale dhe globale; në përmirësimin e njohurive dhe dijeve shkencore dhe teknologjike në këtë fushë; në nxitjen e bashkëpunimit teknik në teknikat e reagimit; dhe, në zhvillimin e programeve të specializuara të trajnimit.

Në përputhje me nenin 2(b) të Konventës për Organizatën Detare Ndërkombëtare dhe sipas Rezolutës 10 të Konferencës së sipërpërmendur, Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar i Organizatës në sesionin e tij të dyzetedytë rekomandoi, dhe Këshilli, në sesionin e tij të tetëdhjetedytë vendosi të mbledhë një konferencë diplomatike për të shqyrtuar miratimin e Protokollit mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme.

Në përputhje me vendimin e Këshillit, konferenca diplomatike u mbledh nga ODN (Organizata Detare Ndërkombëtare) dhe u mbajt në Londër në selinë e saj nga data 9 deri më 15 mars 2000. Përveç aktit përfundimtar, Konferenca miratoi Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000. Konferenca miratoi, gjithashtu, gjashtë rezoluta, të cilat gjenden në shtojcën e aktit përfundimtar.

Ky publikim riprodhon tekstet e aktit përfundimtar të Konferencës, përfshirë shtojcat e saj, dhe Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000.

AKTI PËRFUNDIMTAR I KONFERENCËS PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMBËTAR MBI PËRGATITJEN DHE REAGIMIN NDAJ INCIDENTEVE TË NDOTJES NGA LËNDËT E RREZIKSHME DHE TË DËMSHME

1. Rezoluta 10 e Konferencës së vitit 1990 për Bashkëpunim Ndërkombëtar mbi Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Ndotjes nga Nafta (Konferenca OPRC), ftoi Organizatën Detare Ndërkombëtare (Organizata) për të filluar punën mbi zhvillimin e instrumentit të duhur për zgjerimin e objektit të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 që do të zbatohet tërësisht ose pjesërisht, ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme përveç naftës dhe përgatitjen e propozimit për këtë qëllim.

2. Në përputhje me nenin 2(b) të Konventës për Organizatën Detare Ndërkombëtare dhe sipas rezolutës 10 të Konferencës OPRC, Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar i Organizatës në sesionin e tij të dyzetedytë rekomandoi dhe, Këshilli në sesionin e tij të tetëdhjetedytë, vendosi të mbledhë një konferencë diplomatike për të shqyrtuar miratimin e Protokollit mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme.

3. Konferenca u mbajt në selinë e Organizatës në Londër nga data 9 deri më 15 mars 2000.

4. Në Konferencë morën pjesë përfaqësues nga 79 shtete, domethënë përfaqësuesit nga:

Algjeria	Danimarka
Angola	Republika Dominikane
Antigua dhe Barbuda	Ekuadori
Argjentina	Egjipti
Australia	El Salvadori
Austria	Estonia
Bahamas	Finlanda
Bangladeshi	Franca
Barbados	Gabon
Belgjika	Gjermania
Brazili	Greqia
Kanadaja	India
Kili	Indonezia
Kina	Republika Islamike e Iranit
Kolumbia	Irlanda

Kongo	Izraeli
Bregu i Fildishtë	Italia
Kuba	Xhamajka
Qipro	Japonia
Republika Popullore Demokratike e Koresë	Kenia
Liberia	Letonia
Malajzia	San Vinsent dhe Grenadinet
Malta	Arabia Saudite
Ishujt Marshall	Singapori
Meksika	Slovenia
Maroku	Afrika e Jugut
Namibia	Spanja
Holanda	Suedia
Zelanda e Re	Republika Arabe e Sirisë
Nigeria	Tajlanda
Norvegjia	Trinidad dhe Tabago
Oman	Tunizia
Panama	Turqia
Peru	Ukraina
Filipinet	Mbretëria e Bashkuar
Polonia	Shtetet e Bashkuara
Portugalia	Uruguai
Republika e Koresë	Vanuatu
Federata Ruse	Venezuela
	Jemeni

5. Anëtarit i mëposhtëm i asociuar i Organizatës është përfaqësuar në Konferencë:

Hong Kongu, Kina

6. Organizata e mëposhtme e sistemit të Kombeve të Bashkuara është përfaqësuar në Konferencë:

Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP)

7. Konferencën e ndoqën vëzhgues nga organizatat e mëposhtme ndërqeveritare:

Komisioni i Komunitetit Evropian (EC)

Organizata Satelitore e Telefonisë Celulare Ndërkombëtare (IMSO)

8. Konferencën e ndoqën, gjithashtu, vëzhgues nga organizatat e mëposhtme ndërqeveritare:

Dhoma Ndërkombëtare e Transportit Ujor (ICS)

Bashkimi Ndërkombëtar i Sigurimit Detar (IUMI)

Konfederata Ndërkombëtare e Sindikatave të Tregtisë së Lirë (ICFTU)

Këshilli Detar Ndërkombëtar dhe i Baltikut (BIMCO)

Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive të Klasifikimit (IACS)

Forumi Detar Ndërkombëtar i Kompanive të Naftës (OCIMF)

Federata Ndërkombëtare e Shoqatave të Kapitenëve të Anijeve (IFSMA)

Shoqata Europiane e Ndërtuesve dhe Riparuesve të Anijeve (AWES)

Shoqata me Përgjegjësi të Kufizuar e Anijeve-cisternë me Gaz dhe Operatorëve të Terminaleve Ndërkombëtare (SIGTTO)

Sindikata e Transportit Rrugor Ndërkombëtar (IRU)

Shoqata Ndërkombëtare Greenpeace

Shoqata Ndërkombëtare e Pronarëve të Anijeve me Ngarkesë të Thatë (INTERCARGO)

Instituti i Inxhinierëve të Detarisë (IME)

Federata Ndërkombëtare me Përgjegjësi të Kufizuar kundër Ndotjes e Pronarëve të Anijeve-cisternë (ITOPF)

Sindikata Ndërkombëtare për Ruajtjen e Natyrës dhe Burimeve Natyrore (IUCN)



Shoqata Ndërkombëtare e Prodhuesve të Naftës dhe Gazit (OGP)

Instituti Botëror i Transportit të Lëndëve Nukleare (WNTI)

9. Konferenca u hap nga Z. W. A. O'Neil, Sekretar i Përgjithshëm i Organizatës Detare Ndërkombëtare.

10. Konferenca zgjodhi Z. R. Stamm si President i Konferencës.

11. Zëvendës-presidentët e zgjedhur nga Konferenca ishin:

Kap. L. Diaz-Monclus (Venezuela)

Z. G. Eneh (Nigeria)

Kapit. A. Othman (Malajzia)

12. Sekretariati i Konferencës përbëhej nga nëpunësit e mëposhtëm:

Sekretari i Përgjithshëm: Z. W. A. Neil, Sekretari i Përgjithshëm
i Organizatës Detare Ndërkombëtare

Sekretari ekzekutiv: Z. O. Khalimonov, Drejtori i Seksionit të Mjedisit
Detar

Zëvendëssekretarët
ekzekutivë: Z. K. Sekimizu, Zëvendësdrejtor i lartë
i seksionit të mjedisit detar

Z. J-C. Sainlos, Zëvendës-Drejtor i Lartë
i Seksionit të Mjedisit Detar

13. Konferenca krijoi grupin e punës së Konferencës me mandatin për të shqyrtuar drafttekstin e Protokollit mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme dhe të rezolutave në lidhje me to.

14. Nëpunësit e zgjedhur për grupin e punës së Konferencës ishin si më poshtë:

Kryetar: Z. T. Melhuish (Kanada)

Nënkryetarë: Z. Jin-Ho Park (Republika e Koresë)

Z. Mohamed Ibrahim El Shinawy (Egjypt)

15. Konferenca përdori si bazën e punës së saj dokumentet e mëposhtme të propozuara nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar:

- draftteksti i protokollit mbi përgatitjen, reagimin dhe bashkëpunimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme përgatitur nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar; dhe

- draftrezolutat e konferencës përgatitur nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar.

16. Konferenca shqyrtoi gjithashtu propozimet dhe komentet për dokumentet e sipër përmendura të paraqitura në Konferencë nga qeveritë dhe anëtarët e asociuar të Organizatës.

17. Si rezultat i diskutimeve, të shënuara në raportet e vendimeve të sesioneve plenare, Konferenca miratoi Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000. Protokollin gjendet në shtojcën 1 të aktit përfundimtar.

18. Më tej, Konferenca miratoi rezolutat e mëposhtme:

Rezoluta 1

Aderimi në Konventën Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes, 1990 (Konventa OPRC), si dhe ratifikimi dhe zbatimi i menjëhershëm i Protokollit mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokollin OPRC-HNS)

Rezoluta 2

Hyrja e menjëhershme në fuqi e Konventës Ndërkombëtare mbi Detyrimin dhe Kompensimin për Dëmet në lidhje me Transportin e Lëndëve të Rrezikshme dhe të Dëmshme nga Deti, 1996 (Konventa HNS 1996)

Rezoluta 3	Promovimi i ndihmës teknike
Rezoluta 4	Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme
Rezoluta 5	Bashkëpunimi teknik
Rezoluta 6	Zbatimi i menjëhershëm i dispozitave të nenit 10 të Protokollit mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokollit OPRC-HNS)

Këto rezoluta gjenden në shtojcën 2 të aktit përfundimtar.

19. Akti përfundimtar, përfshirë shtojcat e tij, krijohet në një tekst të vetëm origjinal në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, i cili duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës.

20. Sekretari i Përgjithshëm i Organizatës dërgon kopje të vërtetuara të këtij akti përfundimtar me shtojcën 2 dhe kopje të vërtetuara të Protokollit OPRC-HNS të qeverive të shteteve të ftuara për t'u përfaqësuar në këtë Konferencë në përputhje me dëshirat e këtyre qeverive.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit¹ kanë nënshkruar këtë akt përfundimtar.

Bërë në Londër më 15 mars 2000.

SHTOJCA 1 E AKTIT PËRFUNDIMTAR

PROTOKOLLI

MBI PËRGATITJEN, REAGIMIN DHE BASHKËPUNIMIN NDAJ INCIDENTEVE TË NDOTJES NGA LËNDËT E RREZIKSHME DHE TË DËMSHME, 2000

Palët e këtij Protokollit,

duke qenë palë të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, bërë në Londër më 30 nëntor 1990,

duke marrë parasysh Rezolutën 10, mbi zgjerimin e objektit të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990, për përfshirjen e lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme, miratuar nga Konferenca për Bashkëpunimin Ndërkombëtar mbi Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990,

më tej duke marrë parasysh se sipas Rezolutës 10 të Konferencës për Bashkëpunimin Ndërkombëtar mbi Përgatitjen dhe Reagimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990, Organizata Detare Ndërkombëtare ka intensifikuar punën e saj, në bashkëpunim me të gjitha organizatat ndërkombëtare të interesuara, për të gjitha aspektet e përgatitjes, reagimit dhe bashkëpunimit ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme,

duke marrë parasysh parimin “ndotësi paguan pasojat” si parim i përgjithshëm i së drejtës mjedisore ndërkombëtare,

të vëmendshëm për zhvillimin e strategjisë lidhur me përfshirjen e qasjes paraprake në politikat e Organizatës Detare Ndërkombëtare,

të vetëdijshëm gjithashtu se, në rastin e incidentit të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme, është thelbësore marrja e masave efikase dhe të duhura për të minimizuar dëmet që mund të rrjedhin nga një incident i tillë,

kanë rënë dakord si më poshtë:

¹ Nënshkrimet hiqen.



Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

1. Palët marrin përsipër, individualisht ose bashkërisht, të marrin të gjitha masat e duhura në përputhje me dispozitat e këtij Protokoll dhe aneksit të tij për përgatitjen dhe reagimin ndaj një incidenti ndotjeje nga lëndët e rrezikshme dhe të ndotura.

2. Aneksi i këtij Protokoll është pjesë integrale e këtij Protokoll dhe në të njëjtën kohë referenca e këtij Protokoll përbën një referencë të aneksit.

3. Protokoll nuk gjen zbatim për anijet e luftës, anijet ndihmëse ose anijet e tjera nën zotërimin ose operimin nga shteti dhe të përdorura, për momentin, vetëm për shërbime jotregtare qeveritare. Sidoqoftë, çdo palë duhet të garantojë nëpërmjet miratimit të masave të duhura, mosdëmtimin e operimeve ose aftësive operationale të anijeve që janë nën pronësi ose përdoren prej saj, se anije të tilla veprojnë, për sa është e arsyeshme dhe praktike, në pajtim me këtë Protokoll.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimet e këtij Protokoll:

1. *Incident i ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme* (më tej referuar si “incidenti i ndotjes”) nënkupton një ndodhi ose seri ndodhish me origjinë të njëjtë, përfshirë zjarrin ose eksplozimin, që rezulton ose mund të rezultojë në shkarkimin, çlirimin ose përhapjen e lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme dhe që përbën ose mund të përbëjë rrezik për mjedisin detar, ose për vijën bregdetare apo interesat përkatëse të një ose më shumë shteteve, dhe që kërkon masa emergjente ose reagim të menjëhershëm.

2. *Lëndë të rrezikshme dhe të dëmshme* nënkupton çdo lëndë përveç naftës, e cila nëse depërton në mjedisin detar ka të ngjarë të krijojë rreziqe për shëndetin njerëzor, të dëmtojë burimet e gjalla dhe jetën detare, të dëmtojë bukuritë ose të ndërhyjë në përdorime të tjera legjitime të detit.

3. *Portet detare dhe mjetet e transportit të lëndëve të rrezikshme dhe të ndotura* nënkupton ato porte ose mjete ku ngarkohen dhe shkarkohen këto lëndë nga anijet.

4. *Organizata* nënkupton Organizatën Detare Ndërkombëtare.

5. *Sekretari i Përgjithshëm* nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

6. *Konventa OPRC* nënkupton Konventën Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990.

Neni 3

Planet e emergjencës dhe raportimi

1. Çdo Palë duhet të kërkojë që anijet që janë regjistruar në të, të kenë në bordin e tyre planet e emergjencës në rast incidenti nga ndotja dhe të kërkojë nga kapitenët ose personat e tjerë përgjegjës për anije të tilla të ndjekin procedurat e raportimit në masën e kërkuar. Si kërkesat për planifikimet ashtu edhe procedurat e raportimit duhet të jenë në përputhje me dispozitat e zbatueshme të konventave të krijuara nga Organizata, të cilat kanë hyrë në fuqi për palën përkatëse. Planet e emergjencës në bord në rast incidenti nga ndotja për njësitë në det të hapur, përfshirë produktet lundruese, mjetet e ruajtjes dhe shkarkimit dhe njësitë lundruese të ruajtjes, duhet të trajtohen sipas dispozitave vendase dhe/ose sistemeve të menaxhimit mjedisor të kompanisë dhe përjashtohen nga zbatimi i këtij neni.

2. Çdo palë duhet të kërkojë që autoritetet ose operatorët përgjegjës të porteve detare dhe mjeteve të transportit të lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme nën juridiksionin e saj, nëse ajo e çmon me vend të kenë planet e emergjencës për incidentet në rast ndotjeje ose marrëveshje të ngjashme për lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme që ajo i çmon me vend të cilat koordinohen me sistemet vendase të krijuara sipas nenit 4 dhe të miratuara në përputhje me procedurat e përcaktuara nga autoriteti kompetent vendas.

3. Në rastin kur autoritetet përkatëse të një pale mësojnë për incidentin e ndotjes, ato njoftojnë shtetet e tjera interesat e të cilave mund të preken nga një incident i tillë.

Neni 4

Sistemet kombëtare dhe rajonale për përgatitjen dhe reagimin

1. Çdo palë duhet të përcaktojë një sistem kombëtar për të reaguar menjëherë dhe në mënyrë efektive ndaj incidenteve të ndotjes. Ky sistem duhet të përfshijë minimalisht:

a) përcaktimin e:

i) autoritetit ose autoriteteve vendase kompetente me përgjegjësi për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes;

ii) pikës ose pikave të kontaktit funksional vendas; dhe

iii) autoritetit që ka të drejtë të veprojë në emër të shtetit për të kërkuar ndihmë ose për të marrë vendim lidhur me kërkimin e ndihmës;

b) planin kombëtar për rastet e paparashikuara mbi përgatitjen dhe reagimin që përfshin marrëdhënien organizative të organeve të ndryshme të përfshira, qoftë publike ose private, duke marrë parasysh udhëzuesit e krijuar nga Organizata.

2. Gjithashtu, çdo Palë brenda kapaciteteve të saj si individualisht ose nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh ose shumëpalësh dhe, sipas rastit, në bashkëpunim me industrinë e transportit dhe industrinë që merren me lëndët e rrezikshme dhe të ndotura, autoritetet portuale dhe subjektet e tjera përkatëse, duhet të përcaktojnë:

a) nivelin minimal të pajisjes së parapozicionuar për të reaguar ndaj incidenteve të ndotjes në përputhje me rrezikun e përfshirë dhe programin për përdorimin e saj;

b) programin e ushtrimeve për organizatat e reagimit ndaj incidenteve të ndotjes dhe trajnimin e personelit përkatës;

c) planet e detajuara dhe kapacitetet e komunikimit për të reaguar ndaj incidentit të ndotjes. Kapacitete të tilla duhet të jenë vazhdimisht në dispozicion; dhe

d) mekanizmin ose mjetin e koordinimit të reagimit ndaj incidentit të ndotjes, sipas rastit, me kapacitetet për të vënë në lëvizje burimet e nevojshme.

3. Çdo palë duhet të garantojë njoftimin e Organizatës për informacionet aktuale, drejtpërdrejt ose nëpërmjet organizatës përkatëse rajonale apo marrëveshjeve, në lidhje me:

a) vendndodhjen, të dhënat e telekomunikacionit dhe, sipas rastit, fushat e përgjegjësive së autoriteteve dhe subjekteve të referuara në paragrafin (1)(a);

b) informacionet për pajisjet dhe njohuritë për reagimin ndaj ndotjes në disiplinat që lidhen me reagimin dhe rikuperimin detar ndaj incidenteve të ndotjes, të cilat sipas kërkesës, mund të vihen në dispozicion të shteteve të tjera; dhe

c) planin e saj kombëtar të rasteve të paparashikuara.

Neni 5

Bashkëpunimi ndërkombëtar në reagimin ndaj ndotjes

1. Palët bien dakord që, në varësi të kapaciteteve të tyre dhe disponueshmërisë së burimeve përkatëse, të bashkëpunojnë dhe sigurojnë shërbime këshilluese, mbështetje teknike dhe pajisje për të reaguar ndaj incidenteve të ndotjes, në rastet kur shkalla e incidentit e kërkon një gjë të tillë, sipas kërkesës së ndonjë pale të ndikuar apo që mund të ndikohet. Shpenzimet financiare për një asistencë të tillë bazohen në dispozitat e përcaktuara në aneksin e këtij Protokolli.

2. Pala që ka kërkuar asistencë, mund t'i kërkojë Organizatës të asistojë në përcaktimin e burimeve të financimit të përkohshëm të shpenzimeve të referuara në paragrafin (1).

3. Në përputhje me marrëveshjet e zbatueshme ndërkombëtare, çdo Palë duhet të marrë masat e nevojshme ligjore dhe administrative për të lehtësuar:



a) mbërritjen dhe përdorimin, si dhe nisjen nga territori i tyre i anijeve, aeroplanëve dhe mjeteve të tjera të transportit të angazhuara në reagimin ndaj incidentit të ndotjes ose personelit transportues, ngarkesave, materialeve apo pajisjeve të nevojshme për t'u angazhuar në incidente të tilla; dhe

b) lëvizjen e shpejtë për hyrjen, kalimin dhe daljen nga territori i saj i personelit, ngarkesave, materialeve dhe pajisjeve të referuara në nënparagrafin (a).

Neni 6

Kërkimi dhe zhvillimi

1. Palët bien dakord të bashkëpunojnë drejtpërdrejt ose, sipas rastit, nëpërmjet Organizatës ose organizatave rajonale përkatëse apo marrëveshjeve në promovimin dhe shkëmbimin e rezultateve të programeve të kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me rritjen e nivelit më të lartë të zhvillimit për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes, duke përfshirë teknologjitë dhe teknikat për mbikëqyrjen, kontrollin, riaftësimin, shpërndarjen, pastrimin dhe ndryshe minimizimin ose lehtësimin e efekteve të incidenteve të ndotjes, si dhe për përtëritjen.

2. Për këtë qëllim, palët marrin përsipër të përcaktojnë drejtpërdrejt ose, sipas rastit, nëpërmjet Organizatës ose organizatave rajonale përkatëse apo marrëveshjeve, lidhjet e duhura ndërmjet institucioneve kërkimore të palëve.

3. Palët bien dakord të bashkëpunojnë drejtpërdrejt ose, sipas rastit, nëpërmjet Organizatës ose organizatave rajonale përkatëse apo marrëveshjeve, për të promovuar, sipas rastit, ngritjen mbi baza të rregullta të simpoziumeve ndërkombëtare për temat përkatëse, duke përfshirë përparimet teknologjike të teknikave dhe pajisjeve lidhur me reagimin ndaj incidenteve të ndotjes.

4. Palët bien dakord të nxisin nëpërmjet Organizatës apo organizatave të tjera ndërkombëtare kompetente zhvillimin e standardeve për teknikat dhe pajisjet e pajtueshme që luftojnë ndotjen nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme.

Neni 7

Bashkëpunimi teknik

1. Palët marrin përsipër drejtpërdrejt ose nëpërmjet Organizatës dhe organeve të tjera ndërkombëtare, sipas rastit, në lidhje me përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes, të sigurojnë mbështetje për palët që kërkojnë asistencë teknike:

a) për të trajnuar personelin;

b) për të siguruar disponueshmërinë e teknologjisë, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse;

c) për të lehtësuar marrjen e masave dhe përgatitjeve të tjera lidhur me gatishmërinë dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes; dhe

d) për të filluar programe të përbashkëta kërkimore dhe zhvillimi.

2. Palët marrin përsipër të bashkëpunojnë në mënyrë aktive, sipas ligjeve të tyre vendase, rregulloreve dhe politikave, në transferimin e teknologjisë lidhur me përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes.

Neni 8

Nxitja e bashkëpunimit dypalësh dhe shumëpalësh lidhur me përgatitjen dhe reagimin

Palët duhet të përpiqen të lidhin marrëveshje dypalëshe dhe shumëpalëshe për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes. Kopje të këtyre marrëveshjeve i dërgohen Organizatës, e cila i vë ato në dispozicion të palëve sipas kërkesës së tyre.

Neni 9

Lidhja me konventat e tjera dhe marrëveshjet e tjera

Asgjë në këtë Protokoll nuk do të interpretohet se ndryshon të drejtat ose detyrimet e çdo pale sipas ndonjë konvente tjetër ose marrëveshjeje ndërkombëtare.

Neni 10

Marrëveshjet institucionale

1. Palët përcaktojnë Organizatën, sipas marrëveshjes së saj dhe disponueshmërisë së burimeve të mjaftueshme në mbështetje të veprimtarisë, për të kryer funksionet dhe aktivitetet e mëposhtme:

a) shërbimet informuese:

i) për të marrë, mbledhur dhe shpërndarë sipas kërkesës informacionet e siguruar nga palët dhe informacionet përkatëse të marra nga burime të tjera; dhe

ii) për të siguruar asistencën e duhur në përcaktimin e burimeve të financimit të përkohshëm të shpenzimeve;

b) formimi dhe trajnimi:

i) për të nxitur trajnimin në fushën e përgatitjes dhe reagimit ndaj incidenteve të ndotjes; dhe

ii) për të promovuar mbajtjen e simpoziumeve ndërkombëtare;

c) shërbimet teknike:

i) për të lehtësuar bashkëpunimin në kërkim dhe zhvillim;

ii) për t'i ofruar shteteve ndihmë në përcaktimin e kapaciteteve të vendase dhe rajonale të reagimit; dhe

iii) për të analizuar informacionet e siguruar nga palët dhe informacionet përkatëse të marra nga burime të tjera dhe për t'i ofruar shteteve këshilla ose informacione;

d) asistenca teknike:

i) për të lehtësuar shtetet në marrjen e asistencës teknike në përcaktimin e kapaciteteve të vendase dhe rajonale të reagimit; dhe

ii) për të lehtësuar marrjen e asistencës teknike dhe këshillave, me kërkesën e Shteteve që ndeshen me incidente të mëdha të ndotjes.

2. Në zbatimin e veprimtarive të përcaktuara në këtë nen, Organizata përpaket të fuqizojë aftësinë e shteteve individualisht ose nëpërmjet marrëveshjeve rajonale për t'u përgatitur dhe për të luftuar incidentet e ndotjes, duke u bazuar në përvojën e shteteve, marrëveshjet rajonale dhe përgatitjet industriale, si dhe duke i kushtuar vëmendje të veçantë nevojave të vendeve në zhvillim.

3. Dispozitat e këtij neni zbatohen në përputhje me programin e krijuar dhe të rishikuar nga Organizata.

Neni 11

Vlerësimi i Protokollit

Palët vlerësojnë brenda Organizatës efektivitetin e Protokollit nën dritën e objektivave të saj, veçanërisht në lidhje me parimet thelbësore të bashkëpunimit dhe asistencës.

Neni 12

Ndryshimet

1. Ky Protokoll mund të ndryshohet nga një prej procedurave të përcaktuara në paragrafët e mëposhtëm.

2. Ndryshimi pas shqyrtimit të bërë nga Organizata:

a) Çdo ndryshim i Protokollit i propozuar nga një palë i paraqitet Organizatës dhe i kalon të gjithë anëtarëve të Organizatës dhe të gjitha palëve nga Sekretari i Përgjithshëm të paktën gjashtë muaj para shqyrtimit të tij.

b) Çdo ndryshim i propozuar dhe qarkulluar si më lart, duhet t'i paraqitet Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Organizatës për shqyrtim.



c) Palët e Protokollit, nëse janë ose jo anëtarë të Organizatës, kanë të drejtë të marrin pjesë në procedurat e Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar.

d) Ndryshimet miratohen me shumicë dy të tretat vetëm të palëve të Protokollit të pranishme dhe votuese.

e) Nëse miratohen në përputhje me nënparagrafin (d), ndryshimet u bëhen të ditura nga Sekretari i Përgjithshëm të gjitha palëve të Protokollit për pranim.

f) (i) Ndryshimi i një neni ose aneksi të Protokollit çmohet se është pranuar në datën në të cilën dy të tretat e palëve kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin nga ana e tyre të këtij ndryshimi.

ii) Ndryshimi i një shtojce çmohet se është pranuar në përfundim të periudhës që përcaktohet nga Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar në momentin e miratimit të tij, në përputhje me nënparagrafin (d), periudhë, e cila nuk duhet të jetë më pak se dhjetë muaj, nëse brenda kësaj periudhe Sekretarit të Përgjithshëm nuk i është njoftuar asnjë kundërshtim nga jo më pak se një e treta e palëve.

g) (i) Ndryshimi i një neni ose aneksi të Protokollit i pranuar në pajtim me nënparagrafin (f)(i), hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën çmohet se është pranuar nga palët që kanë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm për pranimin nga ana e tyre të këtij ndryshimi.

ii) Ndryshimi i një shtojce i pranuar në pajtim me nënparagrafin (f)(ii), hyn në fuqi gjashtë muaj pas datës në të cilën çmohet se është pranuar nga të gjitha palët me përjashtimin e atyre që, para kësaj date, e kanë kundërshtuar këtë ndryshim. Një palë, në çdo kohë mund të tërheqë një kundërshtim të njoftuar më parë, duke i paraqitur Sekretarit të Përgjithshëm një njoftim për këtë qëllim.

3. Ndryshimi i bërë nga një Konferencë:

a) Me kërkesë të një pale, për të cilën ka rënë dakord të paktën një e treta e palëve, Sekretari i Përgjithshëm thërret Konferencën e palëve të Protokollit për të shqyrtuar ndryshimet e Protokollit.

b) Ndryshimi i miratuar nga një Konferencë e tillë me shumicë dy të tretat të palëve të pranishme dhe votuese u njoftohet të gjitha palëve nga Sekretari i Përgjithshëm për pranimin nga ana e tyre.

c) Nëse Konferenca nuk vendos ndryshe, ndryshimi konsiderohet i pranuar dhe hyn në fuqi në përputhje me procedurat e përcaktuara në paragrafin (2)(f) dhe (g).

4. Miratimi dhe hyrja në fuqi e ndryshimit që përbën një shtesë të aneksit apo një shtojcë, i nënshtrohet procedurës së zbatueshme për ndryshimin e aneksit.

5. Çdo palë, e cila:

a) nuk ka pranuar ndryshimin e një neni të caktuar apo aneksit sipas paragrafit (2)(f)(i); ose

b) nuk ka pranuar ndryshimin që përbën një shtesë të aneksit ose një shtojcë sipas paragrafit (4); ose

c) ka bërë të ditur kundërshtimin e ndryshimit të shtojcës sipas paragrafit (2)(f) (ii);

do të trajtohet si jopalë vetëm në lidhje me zbatimin e një ndryshimi të tillë. Ky trajtim përfundon me paraqitjen e njoftimit të pranimit sipas paragrafit (2)(f)(i) ose me tërheqjen e kundërshtimit sipas paragrafit (2)(g)(ii).

6. Sekretari i Përgjithshëm njofton të gjitha palët për çdo ndryshim që hyn në fuqi sipas këtij neni, së bashku me datën në të cilën ndryshimi hyn në fuqi.

7. Çdo njoftim për pranimin, kundërshtimin ose tërheqjen e kundërshtimit të ndryshimit sipas këtij neni, do t'i komunikohet me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm, i cili informon palët për këtë njoftim, si dhe datën e marrjes së tij.

8. Shtojca që i bëhet Protokollit përmban vetëm dispozitat me natyrë teknike.

Neni 13

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe anëtarësimi

1. Protokollin mbetet i hapur për nënshkrim në selinë e Organizatës nga data 15 mars 2000 deri më 14 mars 2001 dhe pas kësaj mbetet i hapur për anëtarësim. Çdo shtet palë e Konventës OPRC mund të bëhet palë e këtij Protokollin nëpërmjet:

a) nënshkrimit pa rezerva për ratifikim, pranim ose miratim; ose

b) nënshkrimit objekt i ratifikimit, pranimit ose miratimit, i pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) anëtarësimit.

2. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose anëtarësimi do të kryhet nëpërmjet depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

Neni 14

Shtetet që kanë më shumë se një sistem ligjesh

1. Nëse një shtet palë i Konventës OPRC përbëhet nga dy ose më shumë njësi territoriale në të cilat zbatohen sisteme të ndryshme ligjesh në lidhje me çështjet që trajtohen në këtë Protokoll, në momentin e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, mund të deklarojë se ky Protokoll shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në një apo më shumë prej tyre në të cilat është shtrirë zbatimi i Konventës OPRC, dhe mund të ndryshojë këtë deklaratë nëpërmjet paraqitjes në çdo kohë të një deklaratë tjetër.

2. Çdo deklaratë e tillë i njoftohet me shkrim depozituesit dhe shpreh haptazi njësinë ose njësitë territoriale në të cilat zbatohet Protokollin. Në rastin e ndryshimit, deklarata shpreh hapur njësinë ose njësitë territoriale në të cilat shtrihet më tej zbatimi i Protokollit dhe datën në të cilën hyn në fuqi kjo shtrirje.

Neni 15

Hyrja në fuqi

1. Ky Protokoll hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas datës në të cilën jo më pak se pesëmbëdhjetë shtete e kanë nënshkruar atë pa rezerva për ratifikim, pranim ose miratim apo kanë depozituar instrumentet e nevojshme të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit në përputhje me nenin 13.

2. Për shtetet që kanë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit lidhur me këtë Protokoll pasi janë plotësuar kërkesat për hyrjen e tyre në fuqi, por përpara datës së hyrjes në fuqi, ratifikimi, pranimi, miratimi ose anëtarësimi hyjnë në fuqi datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokollin ose tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit, cilado që është e fundit.

3. Për shtetet që kanë depozituar instrumentin e ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit pas datës së hyrjes në fuqi të Protokollit, ky Protokoll hyn në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit të instrumentit.

4. Pas datës në të cilën një ndryshim i Protokollit konsiderohet se është pranuar sipas nenit 12, çdo instrument i depozituar i ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, gjen zbatim në këtë Protokoll, i ndryshuar.

Neni 16

Denoncimi

1. Ky Protokoll mund të denoncohet nga çdo palë në çdo moment pas skadimit të periudhës prej pesë vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të këtij Protokollin për palën përkatëse.

2. Denoncimi hyn në fuqi nëpërmjet njoftimit me shkrim të Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Denoncimi hyn në fuqi dymbëdhjetë muaj pas marrjes së njoftimit të denoncimit nga Sekretari i Përgjithshëm ose pas mbarimit të çdo periudhe më të gjatë që mund të shënohet në njoftim.

4. Pala që denoncon Konventën OPRC, denoncon gjithashtu automatikisht Protokollin.

Neni 17

Depozituesi

1. Ky Protokoll depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm.



2. Sekretari i Përgjithshëm duhet:

a) të njoftojë të gjitha shtetet që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar për këtë qëllim mbi:

i) çdo nënshkrim të ri ose depozitim të instrumentit të ratifikimit, pranimit, miratimit ose anëtarësimit, së bashku me datën e tij;

ii) çdo deklaratë të bërë sipas nenit 14;

iii) datën e hyrjes në fuqi të këtij Protokoll; dhe

iv) depozitim të çdo instrumenti të shfuqizimit të këtij Protokoll së bashku me datën e marrjes së tij dhe datën e hyrjes në fuqi të shfuqizimit;

b) t'i transmetojë qeverive të të gjitha shteteve që kanë nënshkruar këtë Protokoll ose kanë aderuar për këtë qëllim, kopje të vërtetuara të këtij Protokoll.

3. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të Protokollit në fjalë, depozituesi duhet t'i transmetojë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara një kopje të vërtetuar të tij për regjistrim dhe publikim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 18

Gjuhët

Ky Protokoll hartohet në një kopje të vetme origjinale në gjuhët arabisht, kinezisht, anglisht, frëngjisht, rusisht dhe spanjisht, ku çdo tekst është njëllor autentik.

Në dëshmi të kësaj, nënshkruesit, të autorizuar sipas rregullit nga Qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim, kanë nënshkruar këtë Protokoll².

Bërë në Londër më 15 mars 2000.

ANEKS

RIMBURSIMI I SHPENZIMEVE TË NDIHMËS

1. a) Nëse nuk është lidhur marrëveshja mbi baza dypalëshe ose shumëpalëshe në lidhje me përgatitjet financiare që drejtojnë veprimet e palëve për trajtimin e incidenteve të ndotjes para ndodhjes së tyre, palët duhet të përballojnë shpenzimet e veprimeve të tyre përkatëse lidhur me çështjen e ndotjes në përputhje me nënparagrafin (i) të nënparagrafit (ii).

i) Nëse veprimi është ndërmarrë nga një palë me kërkesën e shprehur të një pale tjetër, pala kërkuese duhet t'i rimbursojë palës ndihmëse shpenzimet e saj. Pala kërkuese mund të anulojë kërkesën e saj në çdo kohë, por në këtë rast ajo duhet të përballojë shpenzimet e pësuara ose të kryera nga pala ndihmëse.

ii) Nëse veprimi është ndërmarrë nga një palë me iniciativën e saj, kjo palë duhet të përballojë shpenzimet e veprimeve të saj.

b) Parimi i përcaktuar në nënparagrafin (a) zbatohet nëse palët e përfshira nuk kanë rënë dakord ndryshe në çdo rast individual.

2. Nëse nuk kanë rënë dakord ndryshe, shpenzimet e veprimeve të ndërmarrë nga një palë me kërkesën e një pale tjetër llogariten sipas ligjit dhe praktikës aktuale të palës ndihmëse lidhur me rimbursimin e shpenzimeve përkatëse.

3. Pala që kërkon ndihmën dhe pala ndihmëse duhet, sipas rastit, të bashkëpunojnë për përfundimin e çdo veprimi në përgjigje të pretendimit për kompensim. Për këtë qëllim, ato duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur regjimeve ligjore ekzistuese. Në rastin kur veprimi i përfunduar nuk lejon kompensimin e plotë për shpenzimet e kryera gjatë operimit të ndihmës, pala që kërkon ndihmë mund t'i kërkojë palës ndihmëse të tërhiqet nga rimbursimi i shpenzimeve që tejkalojnë shumat e kompensuara ose të pakësojë shpenzimet që janë llogaritur në përputhje me paragrafin (2). Gjithashtu, ajo mund të kërkojë shtyrjen e rimbursimit të këtyre shpenzimeve. Në shqyrtimin e një kërkesë të tillë, palët ndihmëse duhet t'i kushtojnë vëmendjen e duhur nevojave të vendeve në zhvillim.

² Nënshkrimet hiqen

4. Dispozitat e Protokollit në fjalë nuk duhet të interpretohen si dispozita që cenojnë të drejtat e palëve për të fituar nga palët e treta shpenzimet e veprimeve që kanë të bëjnë me ndotjen ose rrezikun e ndotjes sipas dispozitave dhe rregullave të tjera të zbatueshme të ligjit vendas dhe ndërkombëtar.

SHTOJCA 2 E AKTIT PËRFUNDIMTAR REZOLUTAT E KONFERENCËS

Rezoluta 1

Aderimi në Konventën Ndërkombëtare për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC), si dhe ratifikimi dhe zbatimi i menjëhershëm i Protokollit për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS)

Konferenca,

Pasi miratoi Protokollin për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS),

E vetëdijshme se, në kohën e miratimit të Protokollit OPRC-HNS, 52 shtete janë palë e Konventës OPRC,

E ndërgjegjshme se aderimi në Konventën OPRC është kusht i domosdoshëm për t'u bërë palë e Protokollit OPRC-HNS,

Duke dëshiruar që dispozitat e Protokollit OPRC-HNS duhet të hyjnë në fuqi sa më shpejt për të lehtësuar bashkëpunimin ndërkombëtar për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme,

1. *Nxit* të gjitha shtetet që nuk janë palë e Konventës OPRC, përfshirë shtetet që nuk kanë marrë pjesë në këtë Konferencë, të aderojnë sa më shpejt në Konventën OPRC;

2. *U kërkon* të gjitha shteteve palë e Konventës OPRC të bëhen palë e Protokollit OPRC-HNS dhe të zbatojnë sa më shpejt dispozitat e tij;

3. *Nxit më tej* të gjitha shtetet për të përcaktuar, sa më shpejt dhe në masën e mundshme, sistemet kombëtare për reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme;

4. *Nxit gjithashtu* të gjitha shtetet, në pritje të hyrjes në fuqi të Protokollit OPRC-HNS, të bashkëpunojnë ndërmjet tyre dhe me Organizatën Detare Ndërkombëtare, për shkëmbimin e informacionit mbi incidentet e ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme dhe për lehtësimin e ndihmës së duhur në rast incidenti të madh ndotjeje.

Rezoluta 2

Hyrja e menjëhershme në fuqi e Konventës Ndërkombëtare mbi Detyrimin dhe Kompensimin për Dëmet në lidhje me Transportin e Lëndëve të Rrezikshme dhe të Dëmshme në Rrugë Detare, 1996 (Konventa HNS 1996)

Konferenca,

Pasi miratoi Protokollin për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS),

Duke pranuar se Konventa Ndërkombëtare për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC) i kushton vëmendje të veçantë Konventës Ndërkombëtare për Përgjegjësinë Civile për Dëmshpërblimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1969 (CLC 1969) dhe Konventës Ndërkombëtare për Përcaktimin e një Fondi Ndërkombëtar lidhur me Kompensimin për Dëmshpërblimin e Ndotjes nga Nafta, 1971 (FONDI 1971) dhe e vetëdijshme për Protokollin e vitit 1992 mbi ndryshimin e Konventës Ndërkombëtare për Përgjegjësinë Civile për Dëmshpërblimin e Ndotjes nga Nafta, 1969 dhe të Protokollit të vitit 1992 mbi ndryshimin e Konventës Ndërkombëtare për Përcaktimin e një Fondi Ndërkombëtar lidhur me Kompensimin për Dëmshpërblimin e Ndotjes nga Nafta, 1971 (FONDI i Protokollit 1992),



Duke pranuar gjithashtu se masat e paraqitura nga Protokollin OPRC-HNS marrin parasysh dispozitat e konventave të tjera të rëndësishme të krijuara nga Organizata Detare Ndërkombëtare, veçanërisht Konventa Ndërkombëtare për Parandalimin e Ndotjes nga Anijet, 1973, e ndryshuar nga Protokollin i vitit 1978 për këtë qëllim, i ndryshuar (MARPOL 73/78),

Duke marrë parasysh regjimin e detyrimit dhe kompensimit të përcaktuar nga Konventa Ndërkombëtare për Detyrimin dhe Kompensimin për Dëmshpërblim në lidhje me Transportin e Lëndëve të Rrezikshme dhe të Dëmshme në Rrugë Detare, 1996,

Duke dëshiruar që dispozitat e Konventës Ndërkombëtare për Detyrimin dhe Kompensimin për Dëmshpërblim në lidhje me Transportin e Lëndëve të Rrezikshme dhe të Dëmshme në Rrugë Detare, 1996, duhet të hyjnë sa më shpejt në fuqi,

U kërkon të gjitha shteteve, duke përfshirë shtetet që nuk kanë marrë pjesë në këtë Konferencë, të bëhen palë e Konventës HNS 1996, me qëllim që të hyjë menjëherë në fuqi.

Rezoluta 3

Promovimi i ndihmës teknike

Konferenca,

Pasi miratoi Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokollin OPRC-HNS),

Duke vënë në dukje se elementet kryesore për suksesin e çdo veprimi në reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme janë organizimi i mirë administrativ në vendet e përfshira në këtë fushë dhe, të paktën, niveli minimal i përgatitjes teknike,

Duke marrë parasysh vështirësitë që mund të ndeshen nga disa shtete të caktuara në përcaktimin e një organizimi të tillë dhe në përgatitjen duke u bazuar në burimet e veta,

Duke pranuar rolin që luan në këtë drejtim Organizata Detare Ndërkombëtare (Organizata), nëpërmjet marrëveshjeve rajonale, bashkëpunimit dypalësh dhe nëpërmjet programeve të qeverisë për industrinë,

Duke pranuar gjithashtu kontributin e dhënë nga programi i bashkëpunimit teknik të Organizatës, Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara, Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara dhe agjencitë vendase të ndihmës në këtë drejtim,

Duke vënë në dukje gjithashtu Rezolutën A.677 (16) e Asamblesë së Organizatës, e cila fton Sekretarin e Përgjithshëm të ndërmarrë mbi baza prioriteti vlerësimin e nevojave teknike të disa vendeve, me qëllim që të krijohen objektivat afatgjatë të programit të asistencës teknike të Organizatës në fushën e mjedisit, dhe për t'i raportuar rezultatin Asamblesë së Organizatës,

1. *U kërkon* shteteve anëtare të Organizatës, në bashkëpunim me Organizatën sipas rastit, shteteve të tjera të interesuara, organizatave kompetente ndërkombëtare dhe rajonale dhe programeve për industrinë, të fuqizojnë mbështetjen për vendet që u nevojitet ndihmë, veçanërisht në:

a) trajnimin e personelit;

b) sigurimin e disponueshmërisë së teknologjive, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse, të nevojshme për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme, për të mundësuar përcaktimin e të paktën strukturave dhe burimeve minimale mbi reagimin ndaj incidenteve të tilla në përputhje me rreziqet e perceptuara të ndotjes;

2. *U kërkon gjithashtu* shteteve anëtare, në bashkëpunim me Organizatën sipas rastit, shteteve të tjera të interesuara, organizatave kompetente ndërkombëtare dhe rajonale dhe programeve për industrinë, të fuqizojnë mbështetjen për vendet që u nevojitet ndihmë në fillimin e programeve të përbashkëta për kërkim dhe zhvillim;

3. *Nxit* shtetet anëtare të sigurojnë pa vonesë këtë mbështetje, ndër të tjera, nëpërmjet bashkëpunimit dypalësh ose shumëpalësh.

Rezoluta 4

Zhvillimi dhe zbatimi i programeve të trajnimit për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme

Konferenca,

Pasi miratoi Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS),

Duke vënë në dukje se elementi kryesor në strategjinë e Organizatës Detare Ndërkombëtare (Organizata) për mbrojtjen e mjedisit detar është rritja e kapacitetit kombëtar dhe rajonal për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe pakësimin e incidenteve të ndotjes detare dhe për promovimin e bashkëpunimit teknik për këtë qëllim,

E vetëdijshme se aftësia e një shteti për të reaguar ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme varet nga vlerësimi fillestar, disponueshmëria e pajisjeve të përshtatshme luftuese kundër lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme, kur është e mundshme, si dhe disponueshmëria e personelit të trajnuar për reagimin,

Duke pranuar rolin e Organizatës në lehtësimin dhe organizimin e kurseve vendase, rajonale dhe globale të trajnimit dhe në zhvillimin e ndihmave trajnuese që synojnë sigurimin e njohurive të nevojshme teknike, në veçanti për vendet që u nevojitet ndihmë në fushën e reagimit ndaj incidenteve të ndotjes detare,

Duke pranuar gjithashtu karakteristikat unike të lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme, si dhe rolin e industrisë veçanërisht të industrisë kimike në sigurimin e trajnimit të specializuar,

Duke pranuar më tej mbështetjen e programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara, Programin e Mjedisit të Kombeve të Bashkuara dhe disa shteteve anëtare të Organizatës për komponentin trajnues të programit për bashkëpunimin teknik të Organizatës,

Duke marrë parasysh nevojën për përpjekje globale në rritje nga të gjitha shtetet e përfshira në transportin detar të lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme dhe ndikimin e tyre mjedisor në zhvillimin e programit global të trajnimit për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme,

1. *Fton* Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës, në bashkëpunim me qeveritë e interesuara, organizatat përkatëse ndërkombëtare dhe rajonale dhe, në veçanti, industrinë kimike dhe të transportit, të marrin masat e duhura që garantojnë zhvillimin e programit të përgjithshëm të trajnimit për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme;

2. *Fton gjithashtu* Komitetin për Mbrojtjen e Mjedisit Detar të Organizatës, mbi bazën e propozimeve të bëra nga Sekretari i Përgjithshëm të shqyrtojë dhe miratojë, sipas rastit, një program të tillë trajnimi për përgatitjen dhe reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme;

3. *Fton më tej* shtetet anëtare të Organizatës të përpiqen për të vënë në dispozicion njohuritë e nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin e programeve përkatëse të trajnimit.

Rezoluta 5

Bashkëpunimi teknik

Konferenca,

Pasi miratoi Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS),

Duke vënë në dukje se elementi kryesor në strategjinë e Organizatës Detare Ndërkombëtare (Organizata) për mbrojtjen e mjedisit detar është rritja e kapacitetit kombëtar dhe rajonal për parandalimin, përgatitjen, reagimin dhe pakësimin e incidenteve të ndotjes detare dhe për promovimin e bashkëpunimit teknik për këtë qëllim,

Duke njohur shumëllojshmërinë e gjerë të lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme, ku çdo lloj kërkon funksione të specializuara reagimi dhe njohuri teknike,

Duke njohur gjithashtu rreziqet e trashëguara të shoqëruara me këto lëndë,



E bindur se është e përshtatshme vendosja e bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet një shteti që ka pësuar ndotje nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme dhe subjekteve që transportojnë këto lëndë në lidhje me transportin detar,

Kërkon bashkëpunimin ndërmjet shteteve anëtare të Organizatës dhe subjekteve që transportojnë lëndë të rrezikshme dhe të dëmshme të sigurojnë ndihmën e duhur për Shtetet që reagojnë ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme.

Rezoluta 6

Zbatimi i menjëhershëm i dispozitave të nenit 10 të Protokollit për Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS)

Konferenca,

Pasi miratoi Protokollin mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Incidenteve të Ndotjes nga Lëndët e Rrezikshme dhe të Dëmshme, 2000 (Protokolli OPRC-HNS),

Duke marrë parasysh dispozitat përkatëse të Konventës Ndërkombëtare mbi Përgatitjen, Reagimin dhe Bashkëpunimin ndaj Ndotjes nga Nafta, 1990 (Konventa OPRC),

Duke vënë në dukje dispozitat e Rezolutës A.448 (XI) të Asamblesë së Organizatës Detare Ndërkombëtare (Organizata) për marrëveshjet rajonale në luftën kundër incidenteve të mëdha apo rreziqeve të ndotjeve detare dhe duke vënë në dukje më tej rezolutat A.349 (IX) dhe A.677 (16) të Asamblesë, për ndihmën teknike në fushën e mbrojtjes së mjedisit detar,

Duke vënë në dukje gjithashtu në veçanti, se neni 10 i Protokollit OPRC-HNS nëpërmjet të cilit palët caktoan Organizatën, sipas marrëveshjes së saj dhe disponueshmërisë së burimeve të mjaftueshme në mbështetje të veprimtarisë, për të kryer funksione dhe veprimtari të caktuara dhe për të përmbushur objektiva të caktuar të Protokollit OPRC-HNS,

Duke njohur rëndësinë e zbatimit të menjëhershëm të objektivave të nenit 10 të Protokollit OPRC-HNS,

1. *Fton* Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës, në pritje të hyrjes në fuqi të Protokollit OPRC-HNS, për të filluar zbatimin e menjëhershëm të funksioneve dhe veprimtarive, me qëllim që të përmbushen objektivat e nenit 10 të Protokollit OPRC-HNS;

2. *Fton gjithashtu* Organizatën të ofrojë një forum për diskutimin e përvojës së fituar nga konventat dhe marrëveshjet rajonale në lidhje me reagimin ndaj incidenteve të ndotjes nga lëndët e rrezikshme dhe të dëmshme;

3. *I kërkon* Sekretarit të Përgjithshëm t'i paraqesë Organizatës, brenda një viti nga mbledhja e Konferencës, programin që tregon mënyrën në të cilën Organizata parashikon kryerjen e detyrave të përmendura në Protokollin OPRC-HNS;

4. *Fton më tej* Organizatën të shqyrtojë periodikisht progresin e bërë në zbatimin e nenit 10 të Protokollit OPRC-HNS dhe nenit 12 të Konventës OPRC, në kuadrin e një organi specifik;

5. *Fton gjithashtu* palët e Konventës OPRC të ndihmojnë Organizatën në sigurimin e bashkëpunimit të një organi të tillë nëpërmjet një njësie mbështetëse.

LIGJ
Nr. 90/2012

PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN
E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fusha e veprimit

1. Qëllimi i këtij ligji është krijimi i një kuadri ligjor të njëjtë për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore nën përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave, më poshtë në tekstin e këtij ligji, “administrata shtetërore”, nëpërmjet përcaktimit të kritereve për krijimin dhe funksionimin e institucioneve shtetërore.

2. Institucionet e arsimit të lartë publik, përfaqësitë diplomatike jashtë vendit, si dhe Forcat e Armatosura nuk janë pjesë e fushës së veprimit të këtij ligji.

Neni 2

Administrata shtetërore dhe funksionet e saj

1. Administrata shtetërore është aparati organizativ dhe profesional, që i shërben interesit publik me paanësi, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, duke kryer shërbimet publike dhe duke hartuar e zbatuar politikat e përgjithshme shtetërore.

2. Funksioneve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni do t’i referohemi si “funksione administrative”.

3. Administrata shtetërore ka personalitet juridik publik dhe përbëhet nga struktura të organizuara në mënyrë hierarkike.

4. Kodi i Procedurës Administrative dhe ligjet sektoriale rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet personave privatë dhe administratës shtetërore në kryerjen e funksioneve administrative dhe vendimmarrjen mbi të drejtat dhe interesat e ligjshëm të këtyre personave.

Neni 3

Parimet e organizimit dhe funksionimit të administratës shtetërore

1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore.

2. Sipas parimit të unitetit dhe hierarkisë, administrata shtetërore organizohet në mënyrë të atillë që çdo organ, institucion apo njësi administrative, është në varësinë dhe i raporton një organi, institucioni apo njësi administrative, eprorë.



3. Sipas parimit të llogaridhënies, çdo organ, institucion apo njësi administrative i nënshtrohet drejtimin dhe mbikëqyrjes nga organi epror përkatës, si për veprimtarinë e vet, ashtu edhe për atë të organeve, institucioneve apo njërive administrative vartëse.

4. Sipas parimit të dekoncentrimit, kryerja e funksioneve administrative, që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me personat privatë, organizohet për t'u kryer sa më afër tyre, me qëllim lehtësimin e aksesit të tyre në informacion, në shërbimet publike, si dhe një pjesëmarrjeje të përshtatshme në procedimin administrativ, sipas ligjit.

5. Sipas parimit të qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë, ndarja dhe caktimi i funksioneve dhe detyrave administrative, ndërmjet organeve, institucioneve dhe njërive administrative, duhet të jenë specifike, të shmangin mbivendosjen, të jenë transparente dhe të bëhen publike në mënyrë të përshtatshme.

6. Sipas parimit të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, caktimi dhe shpërndarja e përgjegjësisë, si dhe organizimi i administratës shtetërore duhet të sigurojnë efektivitetin në kryerjen e funksioneve dhe detyrave, efikasitetin në arritjen e objektivave të politikave të miratuara, si dhe ekonominë në përdorimin e të mirave dhe fondeve publike.

7. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin.

KREU II

TIPOLOGJIA E ORGANIZIMIT TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Neni 4

Organet dhe institucionet e administratës shtetërore

1. Kryeministri dhe ministrat janë organet e larta të administratës shtetërore. Ata drejtojnë dhe mbikëqyrin administratën shtetërore brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Administrata shtetërore përbëhet nga këto institucione:

- a) Kryeministria;
- b) ministritë;
- c) institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave;
- ç) njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve;
- d) agjencitë autonome;
- dh) administrata e prefektit.

3. Ministritë dhe institucionet e varësisë mund të kenë degë territoriale në përputhje me këtë ligj.

4. Organizimi dhe funksionimi i Kryeministrisë rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 5

Ministritë

1. Çdo ministri drejtohet dhe përfaqësohet nga ministri, në vazhdim "ministri përgjegjës". Ministri është përgjegjës përpara Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit për tërësinë e veprimtarisë së ministrisë, institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome, më poshtë "sistem ministror", brenda fushës përkatëse të veprimtarisë shtetërore.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Kryeministrit, përcakton fushën e veprimtarisë shtetërore në përgjegjësinë e çdo ministrie, në vazhdim "fusha e përgjegjësisë shtetërore".

3. Ministria kryen të gjitha funksionet administrative brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore, përveç atyre që u delegohen shprehimisht institucioneve të varësisë apo u ngarkohen me ligj agjencive autonome.

4. Ministria është, gjithashtu, përgjegjëse për koordinimin dhe, në bazë të delegimit të ministrit, për mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të varësisë dhe agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë ministrore.

5. Organizimi i ministrisë përfshin aparatin e ministrisë, si dhe degët e saj territoriale, nëse është rasti.

Neni 6 Institucionet e varësisë

1. Institucionet e varësisë mund krijohen për të kryer ato funksione administrative, të përcaktuara, brenda fushës së përgjegjësisë së përgjithshme shtetërore, kryerja e të cilave kërkon shkallë të lartë specializimi në menaxhim apo drejtim, dhe kanë të bëjnë me zbatimin e drejtpërdrejtë të ligjit, ofrimin e shërbimeve publike për popullatën apo shërbimeve të brendshme për administratën shtetërore ose mbështetje e këshillim për ministrinë.

2. Përveçse kur parashikohen drejtpërdrejt nga ligji, institucionet e varësisë krijohen dhe mbyllen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës apo përkatësisht Kryeministrit, dhe kanë personalitet juridik publik.

3. Në vendimin e Këshillit të Ministrave për krijimin e një institucioni të varësisë përcaktohen, të paktën:

- a) emri dhe selia;
- b) misioni;
- c) funksionet administrative që i delegohen;
- ç) ministri përgjegjës;
- d) organizimi territorial, nëse është i zbatueshëm, si dhe detyrat administrative të degëve territoriale dhe kompetencat e tyre territoriale.

Neni 7 Degët territoriale

1. Degët territoriale janë struktura administrative të një ministrie ose një institucioni të varësisë, që krijohen për të ushtruar në territorin e një ose më shumë njësive të qeverisjes vendore, detyra administrative që mund të kryhen më mirë në territor, në përputhje me parimet e këtij ligji.

2. Degët territoriale krijohen dhe mbyllen me vendim të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës përkatës.

3. Në bazë të marrëveshjes së ministrave përgjegjës dhe të autorizimit të ministrit përgjegjës për administratën publike, disa ministri dhe/apo institucione të varësisë mund të kenë degë të përbashkëta territoriale apo degët territoriale të një ministrie apo institucioni varësie mund të kryejnë detyra administrative për një ministri apo institucion tjetër varësie.

Neni 8 Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve

1. Njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve janë struktura administrative, nëpërmjet të cilave një ministri apo një institucion i varësisë kryen shërbime publike drejtpërdrejt për të tretët, në fushat e parashikuara shprehimisht me ligj.

2. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, njësitë e drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve krijohen dhe mbyllen me urdhër të ministrit përgjegjës përkatës, në përputhje me legjislacionin e posaçëm dhe pas konsultimit publik me përfaqësuesit e përfituesve të mundshëm të shërbimit, me qytetarët e interesuar, me njësitë e qeverisjes vendore dhe me aktorë të tjerë të interesit.

3. Veprimtaria e njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve drejtohet dhe bashkërendohet drejtpërdrejt nga ministria/institucioni i varësisë apo nëpërmjet degëve të tyre përkatëse territoriale.



Neni 9

Administrata e prefektit

1. Administrata e prefektit është administrata që mbështet prefektin në ushtrimin e kompetencave e tij, të parashikuara me ligj.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, administrata e prefektit kryen, në cilësinë e degës territoriale, funksione të tjera administrative brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të një ministrie, që i caktohet prefektit me ligj.

Neni 10

Agjencitë autonome

1. Agjencitë autonome krijohen dhe mbyllen me ligj. Ato gëzojnë personalitet juridik, publik, në marrëdhëniet me të tretët në realizimin e funksioneve të caktuara me ligj.

2. Agjencia autonome kryen funksione administrative të përcaktuara, kryerja e të cilave plotëson së bashku këto kritere:

a) nuk ka nevojë për drejtim dhe mbikëqyrje të përhershme e të drejtpërdrejtë nga Kryeministri apo një ministër;

b) kërkon specializim të thellë në menaxhim;

c) financohet pjesërisht ose krejtësisht nga mjete të tjera të ligjshme, por të ndryshme nga ato të Buxhetit të përgjithshëm të Shtetit.

3. Agjencia autonome krijohet vetëm nëse funksionet administrative, të parashikuara nga pika 2 e këtij neni, realizohen më mirë nga kjo formë organizimi, sesa nga një ministri apo institucion varësie, në përputhje me parimin e ekonomisë, efikasitetit dhe të efektivitetit.

4. Veprimtaria e një agjencie autonome mbikëqyret nga një ministër përgjegjës apo, në raste përjashtimore, nga Kryeministri, sipas përcaktimit në ligjin përkatës të krijimit. Në rast se veprimtaria e një agjencie autonome është në fushën e përgjegjësisë shtetërore të dy ose më shumë ministrive, ministri përgjegjës është ministri, nën përgjegjësinë e të cilit janë kryesisht funksionet e agjencisë autonome. Ministrinë e tjera përfaqësohen në mënyrë proporcionale në strukturat drejtuese të agjencisë.

5. Të gjitha burimet që sigurojnë dhe përdorin agjencitë autonome, buxhetore ose jo, konsiderohen fonde publike dhe si të tilla u nënshtrohen rregullave të menaxhimit financiar të fondeve publike, rregullave të kontabilitetit publik dhe raportimit financiar të Qeverisë dhe janë të kontrollueshme nga ministri përgjegjës apo përkatësisht Kryeministri.

6. Në ligjin për krijimin e agjencisë autonome përcaktohen:

a) emri dhe selia e agjencisë;

b) misioni dhe funksionet e saj administrative;

c) mënyra e organizimit të strukturave drejtuese, numri i anëtarëve të strukturave drejtuese, afati i mandatit të tyre, si dhe kompetencat e tyre;

ç) Kryeministri apo ministri përgjegjës për mbikëqyrjen dhe përfaqësimin e ministrive të tjera të interesuara në strukturat drejtuese, nëse është rasti;

d) burimet e financimit të agjencisë.

7. Në ligjin e krijimit të agjencisë autonome përcaktohet, gjithashtu, regjimi juridik që zbatohet për:

a) personelin, në përputhje me parimet e administrimit të shërbimit civil;

b) financimin dhe shpenzimet;

c) administrimin e asetëve;

ç) procedurat e miratimit të tarifave për shërbimet, nëse është rasti.

8. Në relacionin shpjegues, që shoqëron propozimin e një ligji për krijimin e një agjencie autonome, përfshihen edhe motivimi për përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni dhe një vlerësim bazuar në analizat e kosto-përfitimit ose teknika të tjera moderne të besueshme, që justifikojnë krijimin e një agjencie autonome, sipas pikës 3 të këtij neni.

KREU III
ORGANIZIMI I BRENDSHËM I INSTITUCIONEVE
TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Seksioni 1
Ministritë

Neni 11
Struktura e ministrisë

1. Ministria drejtohet nga ministri, i cili drejton politikën shtetërore për fushën që mbulon punën administrative dhe kontrolluese në institucion. Ministria organizohet në këto struktura organizative hierarkike:

- a) sekretari i përgjithshëm;
- b) drejtoritë e përgjithshme;
- c) drejtoritë;
- ç) sektorët.

Departamentet janë struktura organizative të veçanta, të cilat mbulojnë një funksion të rëndësishëm vetëm të politikëbërjes dhe krijohen në rastet kur përmenden në një ligj të veçantë.

2. Ministri mund t'ua delegojë autoritetin e tij funksionarëve politikë dhe nëpunësve të lartë civilë të ministrisë për plotësimin e detyrave funksionale.

3. Zëvendësministri zëvendëson ministrin, sipas Kodit të Procedurave Administrative. Ata janë pjesë e hierarkisë administrative vetëm kur zëvendësojnë ministrin.

4. Struktura e kabinetit mbështet drejtpërdrejt ministrin në ndjekjen e politikave përkatëse, realizimin e objektivave, si dhe vlerësimin e zbatimit të tyre. Kabineti nuk është pjesë e strukturës hierarkike të ministrisë. Funksionarët e kabinetit nuk ushtrojnë asnjë kompetencë drejtuese ose administrative mbi stafin ministror.

5. Njësitë administrative të parashikuara në pikën 1 të këtij neni organizohen në madhësi të përshtatshme, në bazë të kompleksitetit të detyrave përkatëse. Si rregull, çdo nëpunës civil apo punonjës administrativ është pjesë e një njësie administrative.

6. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, ky nen zbatohet edhe për organizimin e Kryeministrisë.

Neni 12
Sektorët

1. Sektori është struktura administrative më e ulët e organizimit të brendshëm të aparatit të ministrisë dhe është ekskluzivisht përgjegjës për detyrat që i caktohen shprehimisht, brenda fushës së përgjegjësisë shtetërore të ministrisë përkatëse.

2. Sektori drejtohet nga shefi i sektorit, i cili i raporton drejtpërdrejt drejtorit të drejtorisë, pjesë e së cilës është sektori. Shefi i sektorit, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, zëvendësohet, për shkak të ligjit, nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë të të njëjtit sektor. Në rast se ka më shumë se një nëpunës civil të të njëjtit nivel, ai zëvendësohet nga nëpunësi civil i nivelit më të lartë që ka vjetërsi më të madhe në shërbimin civil.

Neni 13
Drejtoritë

1. Drejtoria është grupimi i disa sektorëve me detyra të ndërlidhura. Drejtoria është niveli i dytë më i ulët në strukturën organizative të ministrisë.

2. Drejtoria drejtohet nga drejtori. Përveç kur parashikohet sipas ligjit, drejtori i raporton drejtorit të përgjithshëm ose drejtorit të departamentit, pjesë e të cilit është drejtoria.



3. Drejtori është përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorisë, nëse ato nuk përcaktohen nga një nivel më i lartë hierarkik, për planifikimin e veprimtarisë së drejtorisë dhe realizimin e detyrave të saj, duke dhënë orientime dhe udhëzime, si dhe duke monitoruar veprimtarinë e njësive administrative dhe personelit brenda drejtorisë.

4. Pika 2 e nenit 12 të këtij ligji zbatohet, me ndryshimet përkatëse, për zëvendësimin e drejtorit.

Neni 14

Drejtoritë e përgjithshme dhe departamentet

1. Drejtoritë me funksione të ndërlidhura grupohen në një drejtori të përgjithshme. Drejtoria e përgjithshme drejtohet nga drejtori i përgjithshëm që i raporton sekretarit të përgjithshëm të ministrisë.

2. Përrjashtimisht, me vendim të Këshillit të Ministrave, dy ose më shumë drejtori mund të grupohen në një departament. Departamenti drejtohet nga drejtori i departamentit, i cili i raporton drejtpërdrejt ministrit.

3. Drejtori i përgjithshëm dhe drejtori i departamentit janë përgjegjës për përcaktimin e objektivave të drejtorive përbërëse, përcaktimin e detyrave të drejtorive përbërëse, për monitorimin e veprimtarisë të tyre dhe për sigurimin e koordinimit ndërmjet tyre dhe me njësi të tjera të ministrisë.

4. Pika 2 e nenit 12 të këtij ligji zbatohet, me ndryshimet përkatëse, për zëvendësimin e drejtorit të përgjithshëm dhe drejtorit të departamentit.

Neni 15

Sekretari i përgjithshëm

1. Sekretari i përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në një ministri. Ai i raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te ministri.

2. Sekretari i përgjithshëm ka këto përgjegjësi kryesore:

a) të mbështesë ministrin;

b) të sigurojë zbatimin dhe kontrollin e zbatimit të politikave;

c) të sigurojë drejtimin, mbikëqyrjen dhe koordinimin e ministrisë;

ç) të sigurojë bashkëpunimin me ministrinë e tjera dhe institucionet e organet e pavarura;

d) të sigurojë administrim efektiv dhe eficient të burimeve financiare, materiale dhe njerëzore të sistemit ministror, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

dh) çdo përgjegjësi tjetër që i caktohet nga legjislacioni.

3. Sekretari i përgjithshëm zëvendësohet, në rast mungese apo paaftësie afatshkurtër, nga njëri prej drejtorëve të përgjithshëm të ministrisë.

Neni 16

Strukturat përgjegjëse për funksionet horizontale

1. Menaxhimi i burimeve njerëzore, çështjet juridike, mirëmbajtja dhe shërbimet e tjera mbështetëse kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, në vijim “shërbimet e brendshme mbështetëse”, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

2. Funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar, më poshtë “funksionet e financave”, kryhen të gjitha së bashku nga një strukturë administrative, që i raporton drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm.

3. Funksionet e auditimit të brendshëm kryhen nga një strukturë administrative që i raporton drejtpërdrejt titullarit.

4. Njësitë e parashikuara në pikat 1, 2 e 3 të këtij neni organizohen në sektorë, drejtori apo drejtori të përgjithshme, në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të detyrave përkatëse.

5. Për kryerjen e detyrave të përkohshme, komplekse, që kërkojnë një qasje ndërsektoriale, mund të krijohen grupe pune të përbëra nga nëpunës civilë të ministrisë dhe institucioneve të varësisë.

Ato mund të përfshijnë edhe ekspertë të jashtëm. Grupet e punës krijohen me urdhër të ministrit apo të sekretarit të përgjithshëm. Nëse nuk parashikohet ndryshe në urdhrin përkatës të krijimit, grupi i punës kryesohet nga anëtari që ka nivelin më të lartë të nëpunësit civil. Shpërblimi i ekspertëve të jashtëm rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave dhe specifikohet në urdhrin që krijon grupin e punës.

Neni 17

Kabinetet

1. Kabineti i ministrit mund të ketë një drejtor, këshilltarët dhe sekretarët. Ata emërohen dhe shkarkohen nga ministri dhe kanë statusin e funksionarëve politikë, sipas ligjit.

2. Rregullat për organizimin dhe funksionimin e kabineteve miratohen nga Këshilli i Ministrave. Struktura dhe organika e kabinetit miratohen si pjesë e organizimit të brendshëm të ministrisë.

Seksioni 2

Institucionet e varësisë

Neni 18

Organizimi i brendshëm i institucioneve të varësisë

1. Institucioni i varësisë organizohet si drejtori apo drejtori e përgjithshme, në bazë të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë përkatëse. Niveli i organizimit përcaktohet në vendimin e krijimit.

2. Institucioni i varësisë drejtohet dhe përfaqësohet nga drejtori apo përkatësisht drejtori i përgjithshëm, i cili i raporton ministrit përgjegjës. Në rastet e institucioneve të mëdha dhe me veprimtari shumë komplekse, në vendimin e krijimit të institucionit mund të përcaktohet që drejtori i përgjithshëm apo drejtori të mbështetet nga 1 deri në 2 zëvendës drejtorë.

3. Rregullat për organizimin e brendshëm të ministrive, sipas këtij ligji, zbatohen për organizimin e brendshëm të institucioneve të varësisë, në përputhje me nivelin e organizimit, përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni.

4. Shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe të auditit të brendshëm në institucionet e varësisë me një numër të vogël punonjësish kryhen nga struktura përgjegjëse administrative e ministrisë përgjegjëse.

5. Në rastin e institucioneve të varësisë të mëdha dhe me veprimtari komplekse, strukturat administrative, që kryejnë shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar, si dhe auditimin e brendshëm, krijohen brenda institucionit dhe i raportojnë drejtpërdrejt drejtorit apo përkatësisht drejtorit të përgjithshëm të institucionit.

6. Drejtuesi i institucionit të varësisë mund të krijojë, sipas nevojës, grupe pune. Pika 5 e nenit 16 të këtij ligji zbatohet edhe në këtë rast, me ndryshimet përkatëse.

7. Përveçse kur parashikohet shprehimisht, ndryshe nga ligji i posaçëm, rregullat e parashikuara nga ky nen zbatohen edhe për administratën e prefektit.

Seksioni 3

Degët territoriale

Neni 19

Organizimi i brendshëm i degëve territoriale

1. Në varësi të madhësisë dhe kompleksitetit të veprimtarisë, në vendimin e krijimit të tyre përcaktohet se degët territoriale të ministrive ose të institucioneve të varësisë organizohen si sektorë apo drejtori.

2. Drejtuesi i degës territoriale drejton degën përkatëse territoriale dhe i raporton e i jep llogari drejtpërdrejt sekretarit të përgjithshëm të ministrisë në rastin e degëve të tyre apo përkatësisht drejtuesit të institucionit të varësisë.



3. Sekretari i përgjithshëm ose drejtuesi i institucionit të varësisë mund të caktojë një linjë të ndryshme të raportimit dhe të llogaridhënies së një strukture administrative brenda aparatit të ministrisë apo përkatësisht institucionit të varësisë.

4. Shërbimet e brendshme mbështetëse, funksionet e menaxhimit financiar dhe ato të auditimit të brendshëm për degët territoriale kryhen nga strukturat përgjegjëse administrative të ministrisë ose institucionit të varësisë, pjesë e së cilës është dega.

Seksioni 4 Agjencitë autonome

Neni 20 Organizimi i brendshëm i agjencive autonome

1. Struktura drejtuese e një agjencie autonome përbëhet nga këshilli drejtues dhe drejtori ekzekutiv apo nga një drejtor i përgjithshëm dhe nga një këshill mbikëqyrës. Numri i anëtarëve të këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës duhet të jetë jo më i vogël se tre dhe jo më i madh se shtatë.

2. Drejtori ekzekutiv apo drejtori i përgjithshëm i agjencisë autonome është anëtar i trupës së nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues (TND) dhe caktohet në detyrë nga Kryeministri apo ministri përgjegjës për mbikëqyrjen, në përputhje me ligjin për statusin e nëpunësit civil.

3. Anëtarët e këshillit drejtues dhe këshillit mbikëqyrës emërohen nga Kryeministri apo ministri përgjegjës për mbikëqyrjen dhe nga ministrat e tjerë të interesuar, sipas ligjit të krijimit.

4. Këshilli drejtues ka këto kompetenca:

- a) miraton planin e veprimit, planin financiar, raportin vjetor dhe raporte të tjera të agjencisë;
- b) propozon kandidatët për t'u emëruar drejtorë ekzekutivë, si dhe propozon shkarkimin e tyre;
- c) i siguron drejtorit ekzekutiv udhëzime për veprimtarinë;
- ç) çdo kompetencë tjetër, sipas përcaktimit të ligjit të krijimit.

5. Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr punën e drejtorit në drejtimin e agjencisë dhe ushtron çdo kompetencë tjetër, sipas përcaktimit të ligjit të krijimit.

6. Drejtori ekzekutiv apo drejtori i përgjithshëm drejton dhe përfaqëson agjencinë autonome.

7. Rregullat për organizimin e brendshëm, të parashikuara në këtë ligj për organizimin e institucioneve të varësisë, zbatohen për organizimin e brendshëm të agjencive autonome, për aq sa nuk parashikohet shprehimisht ndryshe në ligjin e krijimit.

8. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të strukturave drejtuese, si dhe rregullat për shpërbimin e tyre.

Seksioni 5 Procedura e miratimit të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore

Neni 21 Miratimi i organizimit të brendshëm

1. Organizimi i brendshëm i institucioneve të administratës shtetërore përbëhet nga:

a) struktura funksionale;
b) organika e hollësishme e institucionit, që përfshin edhe klasifikimin e pozicioneve të punës, në bazë të legjislacionit të nëpunësit civil.

2. Organizimi i brendshëm i ministrive dhe institucioneve të varësisë, përfshirë edhe degët e tyre territoriale, miratohet me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës dhe pas marrjes së mendimit të ministrit përgjegjës për financat. Departamenti i Administratës Publike harton projekt-urdhrat dhe ia dërgon për shqyrtim dhe miratim Kryeministrit.

3. Organizimi i brendshëm i njësive të drejtpërdrejta të ofrimit të shërbimeve miratohet me urdhër të ministrit përgjegjës, pas pëlqimit paraprak të ministrit përgjegjës për financat.

4. Organizimi i brendshëm i agjencive autonome miratohet nga organi i përcaktuar në ligjin për krijimin e agjencisë, pas konsultimit me ministrin përgjegjës për administratën publike dhe me Kryeministrin apo ministrin përgjegjës për mbikëqyrjen.

5. Këshilli i Ministrave:

a) miraton rregulla të hollësishme për organizimin e brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore;

b) bën përshkrimin e përgjithshëm të punës së secilit tip të njësive administrative të institucioneve të administratës shtetërore;

c) miraton procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm, si dhe përmbajtjen e relacionit shoqërues të propozimit.

KREU IV MBIKËQYRJA E ADMINISTRATËS SHTETËRORE

Neni 22

Përgjegjësia për mbikëqyrjen

1. Çdo ministër është përgjegjës për mbikëqyrjen e veprimtarisë së ministrisë, të institucioneve të varësisë dhe të agjencive autonome brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore. Kryeministri është përgjegjës për mbikëqyrjen e institucioneve të varësisë ose të agjencive autonome në varësi të tij.

2. Kryeministri ose ministri përgjegjës, respektivisht, mund t'i delegojë një strukturë administrative të aparatit të ministrisë përkatëse ose përkatësisht Kryeministrisë kompetencën për ushtrimin e mbikëqyrjes së institucioneve të veçanta të varësisë ose të agjencive autonome. Në këtë rast, drejtuesi i strukturës administrative të ngarkuar është zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen.

3. Kryeministri apo ministri përgjegjës prezumohet si zyrtar përgjegjës për mbikëqyrjen deri në dhënien e delegimit, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 23

Mbikëqyrja e institucioneve të varësisë dhe e agjencive autonome

1. Institucionet e varësisë dhe agjencitë autonome mbikëqyren për:

a) realizimin e objektivave të miratuar politikë dhe të menaxhimit;

b) ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e veprimeve të tyre administrative, administrimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e buxhetit, administrimin e pasurive dhe menaxhimin financiar.

2. Zyrtari përgjegjës për mbikëqyrje ka të drejtë:

a) të kërkojë raportim dhe informacion të rregullt dhe të posaçëm për veprimtarinë e përgjithshme administrative dhe menaxhimin e brendshëm, si dhe për çështje konkrete administrative;

b) të ndërmarrë inspektime në vend dhe të inspektojë dosjet;

c) të përcaktojë objektivat e politikave të institucionit të varësisë dhe të agjencive autonome;

ç) të japë udhëzime dhe urdhra të përgjithshëm për veprimtarinë administrative dhe për çështje të menaxhimit të brendshëm;

d) të urdhërojë kryerjen e detyrave apo ndërmarrjen e masave të caktuara;

dh) të miratojë paraprakisht projektbuxhetin e institucionit të varësisë dhe të bëjë propozimin për financim nga Buxheti i Shtetit të agjencisë autonome, në përputhje me ligjin.

3. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji, zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen, gjithashtu, ka të drejtë:

a) të urdhërojë fillimin, kryesisht, të një procedimi të caktuar administrativ nga institucioni i varësisë apo agjencia autonome;



b) të udhëzojë një institucion të varësisë apo agjenci autonome të pezullojë ekzekutimin e një akti administrativ të lëshuar nga ai vetë;

c) të urdhërojë institucionin e varësisë apo agjencinë autonome të ndryshojë ose të revokojë një akt administrativ.

4. Në rast se një institucion i varësisë nuk zbaton udhëzimet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, brenda një afati të arsyeshëm, zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen ushtron drejtpërdrejt kompetencat e institucionit të varësisë dhe vepron në vend të tij.

5. Zyrtari përgjegjës për mbikëqyrjen është, gjithashtu, “organi epror” i institucionit të varësisë apo agjencisë autonome në procedurën e ankimit administrativ, sipas Kodit të Procedurave Administrative.

KREU V BASHKËPUNIMI DHE BASHKËRENDIMI NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Neni 24 **Bashkëpunimi**

1. Institucionet e administratës shtetërore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me institucionet e tjera shtetërore e me njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Institucionet e administratës shtetërore:

a) i sigurojnë njëri-tjetrit të dhëna, informacione dhe ndihmën e nevojshme për kryerjen e funksioneve të tyre;

b) krijojnë grupe të përbashkëta pune për hartimin e strategjive, politikave, studimeve ose projekt-akteve të veçanta për administrimin e zbatimit të projekteve të Qeverisë;

c) krijojnë njësi të përbashkëta për të kryer detyra administrative, të cilat për nga natyra e tyre kërkojnë pjesëmarrjen e disa institucioneve.

3. Grupet e përbashkëta të punës ngrihen me urdhër të përbashkët të ministrave të përfshirë. Kur nuk arrihet një marrëveshje nga ministrat e përfshirë, grupet e përbashkëta të punës krijohen me urdhër të Kryeministrit. Grupet e përbashkëta të punës përbëhen nga nëpunësit civilë dhe funksionarët politikë të ministrive përkatëse. Në to mund të përfshihen edhe ekspertë të jashtëm. Në rastet kur një detyrë e veçantë ka të bëjë me dy ose më shumë ministri, grupi i punës kryesohet nga një përfaqësues i ministrisë, së cilës i përket kryesisht detyra, ministrinë e tjera duhet të bashkëpunojnë në mënyrë të rregullt.

4. Kryeministri mund të autorizojë një ministër për të administruar ose koordinuar punën e dy ose më shumë ministrive për hartimin e politikave ose për të administruar zbatimin e një projekti qeveritar që u përket fushave të përgjegjësisë shtetërore të disa ministrive.

5. Procedurat e bashkëpunimit për secilën nga format e parashikuara në pikën 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 25 **Bashkërendimi dhe shkëmbimi i informacionit**

1. Ministrinë i dërgojnë informacion, në përputhje me legjislacionin përkatës, Presidentit dhe Kuvendit përmes Këshillit të Ministrave. Ata mund të dërgojnë informacion drejtpërsëdrejti te njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me legjislacionin përkatës.

2. Institucionet e varësisë dhe agjencitë e pavarura komunikojnë me Presidentin dhe me Kuvendin nëpërmjet ministrisë përgjegjëse apo përkatësisht Kryeministrit.

3. Ministrinë, institucionet e tyre të varësisë dhe organet autonome dorëzojnë informacione, dokumente dhe materiale të tjera te gjykatat, në bazë të ligjit përkatës procedural.

KREU VI
DELEGIMI I FUNKSIONEVE NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE

Neni 26
Justifikimi i delegimit

1. Ministrinë mund të delegojnë funksione të caktuara apo ofrimin e shërbimeve publike te njësitë e qeverisjes vendore. Ky delegim shoqërohet me transferimin e fondeve të mjaftueshme për të kryer detyrat e deleguara.

2. Detyrat e caktuara administrative, lidhur me ofrimin e shërbimeve publike, mund t'u delegohen edhe personave privatë, fitimprurës ose jofitimprurës.

3. Delegimi, sipas këtij neni, nuk përfshin transferimin e përgjegjësisë për detyrën e deleguar.

4. Një detyrë administrative mund të delegohet në qoftë se plotësohen së bashku këto kushte:

a) realizimi i detyrës nga palët e treta justifikohet ekonomikisht;

b) delegimi nuk dëmton cilësinë e shërbimit publik që kryhet nëpërmjet delegimit;

c) delegimi nuk do të cenonte interesat publikë apo të drejtat e interesat e ligjshëm të personave, ndaj të cilëve ekziston detyrimi për shërbimin publik;

ç) delegimi nuk do të cenojë kryerjen e vazhdueshme dhe efektive të shërbimit publik të deleguar;

d) autoriteti delegues ka kapacitet të mjaftueshëm për të monitoruar dhe mbikëqyrur zbatimin e detyrave të deleguara.

Neni 27
Procedura e delegimit

1. Delegimi te njësitë e qeverisjes vendore bëhet me ligj ose me marrëveshje, sipas ligjit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

2. Delegimi te personat privatë realizohet nëpërmjet procedurave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Në aktin e delegimit përcaktohen:

a) funksionet e deleguara;

b) kompetencat dhe detyrat e transferuara;

c) financimi i detyrave të deleguara;

ç) institucioni i ngarkuar me mbikëqyrjen, si dhe objektet e instrumentet e mbikëqyrjes;

d) kriteret e ndërprerjes dhe mekanizmat për kryerjen e detyrave të deleguara në rast të ndërprerjes së delegimit.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT DHE KALIMTARE

Neni 28
Vlerësimi dhe modernizimi

1. Organizimi dhe funksionimi i institucioneve të administratës shtetërore janë objekt i vlerësimit dhe reformimit të vazhdueshëm, për të siguruar përputhshmërinë me dispozitat e këtij ligji.

2. Çdo ministër është përgjegjës për vlerësimin e përputhshmërisë me këtë ligj dhe modernizimin e organizimit të institucioneve brenda fushës përkatëse të përgjegjësisë shtetërore.

3. Ministria përgjegjëse për administratën publike mbështet ministrinë, harton propozime, jep miratimin paraprak për çdo projekt-akt ligjor apo nënligjor që rregullon çështje të organizimit dhe funksionimit të institucioneve të administratës publike, mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, si dhe paraqet në Këshillin e Ministrave një raport për gjendjen çdo dy vjet.



Neni 29

Rregulloret e brendshme

1. Këshilli i Ministrave miraton rregullore, brenda kuadrit të legjislacionit të përgjithshëm përkatës, për standardet e përbashkëta të menaxhimit në institucionet e administratës shtetërore, përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, procedurat e punës dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive administrative dhe institucioneve të administratës shtetërore.

2. Rregulloret që përcaktojnë metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit miratohen nga ministri përgjegjës për ministrinë, institucionet e varësisë dhe degët territoriale në varësi të tij.

3. Rregulloret e brendshme publikohen në mënyrë të përshtatshme.

Neni 30

Periudha kalimtare dhe aktet nënligjore

1. Këshilli i Ministrave miraton apo, përkatësisht, propozon, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ndryshimet në legjislacionin ekzistues për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të administratës shtetërore, për përshtatjen e tyre me dispozitat e këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave miraton aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, siç kërkohet në dispozitat përkatëse, veçanërisht në pikën 5 të nenit 16, në pikën 2 të nenit 17, në pikën 8 të nenit 20, në pikën 5 të nenit 21 dhe në pikën 5 të nenit 24 të këtij ligji.

Neni 31

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 27.9.2012

**Shpallur me dekreten nr.7791, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 91/2012

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9109, DATË 7.7.2003 “PËR PROFESIONIN E AVOKATIT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9109, datë 17.7.2003 “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 9 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët “duke treguar kujdesin e një profesionisti të arsyeshëm, sipas “Kodit të etikës së avokatit ””.

2. Në fund të pikës 6 shtohen fjalët “si dhe kur ka këshilluar, përfaqësuar ose ka pasur të bëjë në mënyrë tjetër profesionale me një palë tjetër në të njëjtën çështje.”.

3. Pas pikës 9 shtohen pikat 10 e 11 me këtë përmbajtje:

“10. Avokati, në rastin e pengesës dhe për aq kohë sa zgjat ajo, me pëlqimin e personave që mbrohen ose përfaqësohen prej tij, mund të caktojë një zëvendësues, i cili ushtron të drejtat dhe merr përsipër detyrimet e avokatit. Pëlqimi i palës për caktimin e një zëvendësuesi mund të jepet në aktin e përfaqësimit.

11. Avokati duhet të lidhë kontratë sigurimi për të garantuar përgjegjësinë e tij ndaj palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së tij.”.

Neni 2

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Rregullat e hollësishme për ushtrimin e profesionit të avokatit, në përputhje me këtë ligj, caktohen në statutin dhe në “Kodin e etikës së avokatit”, të miratuara nga Këshilli i Përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.

Neni 3

Në nenin 11, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, pasi marrin mendimin e Ministrisë së Financave, caktojnë tarifat e shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike, të cilat zbatohen kur nuk ka marrëveshje të ndryshme me shkrim mes avokatit dhe personit të mbrojtur ose të përfaqësuar prej tij dhe kur ndihma juridike nuk është dhënë sipas dispozitave për ndihmën juridike.”.

Neni 4

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

1. Avokati ndjek programin e trajnimit vazhdues, të organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhe pajiset prej saj me vërtetimin përkatës për ndjekjen e këtij programi.

2. Programi i trajnimit vazhdues synon përditësimin e avokatëve me njohuri specifike profesionale, teorike dhe praktike.

3. Në rast të mospërmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues nga avokati, zbatohet neni 46 i këtij ligji.

4. Rregullat e hollësishme për pjesëmarrjen në trajnim, organizimin, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të tij përcaktohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe rregulloren e programit të trajnimit, që miratohet me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.

Neni 5

Në nenin 19 pika 3, shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Këshillin Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillit drejtues rregullohet në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.



Neni 6

Në nenin 20 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë në takimin e tij të parë, me propozim të Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, zgjedh sekretarin e përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Sekretari i përgjithshëm shkarkohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, me propozim të Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Procedurat e propozimit dhe të emërimit të sekretarit të përgjithshëm rregullohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.

2. Në pikën 3, shkronja “e” shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 25, pas shkronjës “a” shtohet shkronja “a/1” me këtë përmbajtje:

“a/1) të ketë përfunduar me sukses programin e trajnimit për kandidatët për avokatë, në përputhje me rregullat e përcaktuara në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë, si dhe rregulloren përkatëse të trajnimit, që miratohet me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.”.

Neni 8

Pas nenit 25 shtohet neni 25/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 25/1

1. Kandidati për avokat ndjek programin e trajnimit, të organizuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë, dhe, pasi vlerësohet, pajiset prej saj me vërtetimin përkatës për ndjekjen e këtij programi.

2. Programi i trajnimit synon përgatitjen e kandidatëve për avokat me njohuri specifike profesionale, teorike dhe praktike.

3. Rregullat e hollësishme për pjesëmarrjen në trajnim, kohëzgjatjen dhe mënyrën e zhvillimit të tij përcaktohen në rregulloren e trajnimit të kandidatëve për avokat, që miratohet me vendim të Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

4. Shkolla Kombëtare e Avokatisë është organi i Dhomës Kombëtare të Avokatisë që merret me përgatitjen e programeve të trajnimit, organizimin dhe administrimin e trajnimit fillestar të kandidatëve për avokat dhe trajnimin e vazhduar të avokatëve. Dhoma Kombëtare e Avokatisë duhet të krijojë këtë shkollë brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.”.

Neni 9

Në nenin 27 pikat 1, 2 e 3, pas fjalëve “në provimin e kualifikimit” shtohen fjalët “ose në programin e trajnimit”.

Neni 10

Në nenin 28, fjalët “në shkronjën “b” të pikës 1 të nenit 25 të këtij ligji,” zëvendësohen me fjalët “në shkronjat “a/1” dhe “b” të nenit 25 të këtij ligji.”.

Neni 11

Neni 33 shfuqizohet.

Neni 12

Në nenin 34 pika 2, pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje: “g) të dhëna për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues.”.

Neni 13

Në nenin 35 pika 2, pas shkronjës “f” shtohet shkronja “g” me këtë përmbajtje: “g) të dhëna për ndjekjen e programit të trajnimit për kandidatët për avokatë.”.

Neni 14

Kreu VIII ndryshohet si më poshtë:

“KREU VIII PROCEDIMI DISIPLINOR I AVOKATËVE

Neni 37

Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 39 paraqesin ankesë për:

- a) “Sjelljet joprofesionale të avokatit”, ku përfshihen veprimi në kundërshtim me dispozitat ligjore apo nënligjore, si dhe ato të Kodit të Etikës.
- b) “Shërbimet e papërshtatshme profesionale”, ku përfshihen veprime apo mosveprime ndaj të përfaqësuarit, të cilat janë dukshëm nën nivelin e pritshmërisë së tij për një avokat.

Neni 38

1. Avokati i nënshtrohet procedimit disiplinor nëse:

- a) ka vepruar në kundërshtim me rregullat e përcaktuara:
 - i) në dispozitat ligjore dhe nënligjore që rregullojnë profesionin e avokatit;
 - ii) në dispozitat e “Kodit të etikës së avokatit”;
 - iii) nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe dhomat e avokatisë;
 - iv) në legjislacionin tatimor;
- b) ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore procedurale që rregullojnë veprimtarinë e avokatit, duke cenuar rëndë ose në mënyrë të përsëritur procesin e rregullt ligjor;
- c) ka kryer akte dhe sjellje të rënda që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e avokatit.

2. Në rast të procedimeve penale, që lindin nga të njëjtat rrethana si rrethanat që çojnë në procedim disiplinor, procedimi disiplinor pezullohet dhe afati kohor shtyhet deri në përfundim të procedimit penal dhe çdo dënim penal pranohet në procedimin disiplinor.

Neni 39

1. Ankesat kundër avokatit mund të paraqiten nga:

- a) çdo person që mbrohet, përfaqësohet ose ndihmohet juridikisht prej tij;
- b) çdo person i interesuar, që pretendon se është dëmtuar nga sjellja apo veprimet e avokatit;
- c) organet drejtuese të dhomave të avokatisë;
- ç) një avokat tjetër;
- d) Ministri i Drejtësisë;
- dh) gjyqtarët dhe prokurorët;
- e) organet tatimore;
- ë) çdo organ tjetër shtetëror, i parashikuar me ligj.



2. Ankesat mund të bëhen brenda 6 muajve nga data e sjelljes ose veprimit të avokatit apo nga data e konstatimit të sjelljes ose veprimit të avokatit, por, në çdo rast, jo më vonë se 1 vit nga momenti i kryerjes së shkeljes. Pas kalimit të këtij afati, ankuesi ka të drejtë të kërkojë pranë Komisionerit të Ankimeve rivendosjen në afat, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3. Afati kohor për përfundimin e procesit disiplinor është 3 muaj nga data e depozitimit të ankesës. Ky afat mund të zgjatet me pëlqimin me shkrim të ankuesit dhe avokatit ose nga vetë Komisioneri i Ankimeve, kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme, për një periudhë jo më shumë se 6 muaj nga data e depozitimit të ankesës.

Neni 40

1. Ankesat për çdo sjellje ose veprim të avokatit i drejtohen Kryetarit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, i cili ia përcjell ankesën brenda 5 ditëve Komisionerit të Ankimeve, duke njoftuar për këtë edhe ankuesin.

2. Nëse Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë nuk e përcjell ankesën brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, ankuesi ka të drejtë ta paraqesë atë pranë Komisionerit të Ankimeve.

Neni 41

1. Komisioner i Ankimeve caktohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë një person me integritet të lartë moral dhe profesional. Kriteret e emërimit dhe shkarkimit, statusi, si dhe mënyra e ushtrimit të përgjegjësive prej tij përcaktohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

2. Komisioneri i Ankimeve është përgjegjës për të filluar procedimin disiplinor, si dhe për të shqyrtuar dhe hetuar për ankimin e paraqitur, brenda 20 ditëve nga momenti i regjistrimit të ankimit. Në përfundim të hetimeve, ai përgatit një relacion të hollësishëm për ankimin drejtuar komitetit disiplinor. Për kalimin e ankesës në komitetin disiplinor, Komisioneri i Ankimeve njofton njëkohësisht ankuesin dhe avokatin që është subjekt ankimi.

3. Komisioneri i Ankimeve ushtron këto përgjegjësi:

a) informon dhe ndihmon ankuesin gjatë procesit të përgatitjes së ankimit;

b) regjistron dhe verifikon ankimin për plotësimin e kriterëve të parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 39 të këtij ligji;

c) refuzon ankimet që nuk plotësojnë kriteret e parashikuara në pikat 1 e 2 të nenit 39 të këtij ligji;

ç) informon ankuesin për mospranimin e ankimit, si dhe për të drejtën për të paraqitur ankim ndaj vendimit të mospranimit përpara komitetit disiplinor;

d) kërkon nga avokati që është subjekt ankimi shpjegime me shkrim lidhur me ankimin, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit;

dh) i paraqet relacionin për ankimin komitetit disiplinor, duke njoftuar për këtë edhe ankuesin;

e) raporton përpara komitetit disiplinor, sa herë që kërkohet prej këtij komiteti;

ë) përmbush detyrat e tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

4. Nëse Komisioneri i Ankimeve nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, ankuesi ose, në rastin e një ankuesi gjyqtar, Ministri i Drejtësisë, ka të drejtë të paraqesë ankesën, brenda 15 ditëve nga kalimi i afatit, drejtpërdrejt pranë komitetit disiplinor, i cili, pasi verifikon shkeljen e afateve, cakton një nga anëtarët e tij si relator të çështjes. Ai ushtron, për aq sa është e mundur, përgjegjësitë e Komisionerit të Ankimeve dhe nuk merr pjesë në votimin përfundimtar të komisionit.

5. Kundër vendimit të Komisionerit të Ankimeve, ankuesi ose, në rastin e një ankuesi gjyqtar, Ministri i Drejtësisë, ka të drejtë të paraqesë ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, pranë komitetit disiplinor.

Neni 42

1. Komiteti disiplinor është një organ kolegjal i përbërë nga:
 - a) 6 avokatë, të cilët zgjidhen me votim të fshehtë nga anëtarësia e Këshillit të Përgjithshëm të Dhomës Kombëtare të Avokatisë;
 - b) një përfaqësues, i caktuar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë;
 - c) një përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë;
 - ç) një përfaqësues i shoqërisë civile ose botës akademike, i zgjedhur sipas rregullave të përcaktuara në statut.
2. Kryetari i komitetit disiplinor zgjidhet nga Këshilli Drejtues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë mes anëtarëve të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, për një mandat dyvjeçar, ndërsa anëtarët e tij zgjidhen për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.
3. Komiteti disiplinor ushtron këto përgjegjësi:
 - a) shqyrton vendimet e Komisionerit të Ankimeve, duke vendosur për:
 - i) pranimin e ankesës dhe marrjen e masës disiplinore ndaj avokatit;
 - ii) mospranimin e ankesës;
 - b) në rast se vendos të pranojë ankesën e refuzuar nga Komisioneri i Ankimeve dhe fillimin e shqyrtimit të ankesës së paraqitur, ai emëron tre nga anëtarët e tij për të ushtruar funksionet e Komisionerit të Ankimeve.
4. Komiteti disiplinor zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve të tij.
5. Komiteti disiplinor shqyrton dhe merr vendim për ankimin brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së ankimit apo dërgimit pranë tij. Vendimet e komitetit disiplinor merren me shumicë votash të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, duhet të jenë të arsyetuara dhe u njoftohen ankuesit dhe avokatit, kundër të cilit është paraqitur ankimi.
6. Nëse komiteti disiplinor nuk respekton afatin e përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, ankuesi ka të drejtë të paraqesë ankesën, brenda 15 ditëve nga data e mbarimit të afatit, drejtpërdrejt në gjykatën kompetente që ka kompetencë të detyrojë komitetin disiplinor për kryerjen e detyrave të tij dhe të shtyjë kohën.
7. Kundër vendimit të komitetit disiplinor ankuesi dhe avokati, që është subjekt ankimi, kanë të drejtë të paraqesin ankim, brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit, në gjykatën kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve administrative.
8. Rregullat e hollësishme të procesit disiplinor, të funksionimit të komitetit disiplinor, mënyrës së ushtrimit të përgjegjësisë prej tij, si dhe shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 43

1. Gjykata kompetente shqyrton ankesat kundër vendimeve të komitetit disiplinor ose ankesat për procedim disiplinor të avokatëve, në rastin e parashikuar në pikën 7 të nenit 42 të këtij ligji, sipas afateve për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative.
2. Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë, sipas këtij neni, gjykata zbaton dispozitat e legjislacioni në fuqi për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, Kodit të Procedurës Civile, si dhe, për aq sa është e mundur, edhe rregullat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 44

1. Masat disiplinore arsyetohen dhe merren sipas një procedure transparente dhe në përputhje me të drejtën për një proces të rregullt ligjor, e cila garanton të drejtën për t'u informuar, për të kërkuar sqarime rreth fakteve, për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur.
2. Palët në procedimin disiplinor kanë të drejtë të paraqiten dhe të japin shpjegime në seancë, vetë ose nëpërmjet mbrojtjes e përfaqësimit me avokat. Nëse njëra ose të dyja palët nuk paraqiten në



seancë, pa motive të arsyeshme, Komiteti Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë shqyrton çështjen dhe merr vendim në mungesë të tyre.

3. Shpjegimet e palëve dhe dëshmitë në seancë mund të jepen me gojë ose me shkrim.

4. Avokati, ndaj të cilit është paraqitur ankesa/kërkesa, duhet të paraqesë, me shkrim, argumentet e tij për ankesën/kërkesën brenda 15 ditëve nga data e marrjes së njoftimit. Mosparaqitja e pretendimeve nga avokati nuk përbën shkak për mosvazhdimin e procedimit disiplinor.

5. Komiteti Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë pranon dëshmitë dhe dokumentet e paraqitura para tij, me cilësinë e provës, dhe i çmon ato sipas bindjes së formuar, pas shqyrtimit të tyre në tërësi.

6. Në raste të ndërlikuara, Komisioneri i Ankimeve thërret një avokat për të bashkëpërfaqësuar çështjen kundër avokatit para komitetit disiplinor.

Neni 45

1. Masat disiplinore jepen bazuar në natyrën dhe rëndësinë e shkeljes. Vendimi mund të parashikojë një masë të përbërë nga dy ose më shumë lloje masash disiplinore, nëse kjo është e përshtatshme dhe në proporcion me shkeljen.

2. Për shkeljet që klasifikohen si sjellje joprofesionale, komiteti disiplinor jep njërën nga masat disiplinore të mëposhtme:

a) heqjen e së drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatit;

b) pezullimin e lejes për ushtrimin e profesionit të avokatit, për një periudhë prej 3 muajsh deri në 2 vjet;

c) gjobë nga 5 000 deri në 50 000 lekë;

ç) rikthimin e pagesës ose anulimin e pagesës së shërbimit ndaj të përfaqësuarit;

d) urdhërimin e avokatit për të bërë provim, brenda një periudhe të caktuar, lidhur me etikën profesionale, sipas rregullave të përcaktuara në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë;

dh) urdhërimin e avokatit për të bërë trajnim vazhdues shtesë, përfshirë edhe trajnim në një fushë të veçantë të ligjit;

e) vërejtje me shkrim;

ë) këshillim për sjelljen në mënyrën e duhur në të ardhmen;

f) urdhër për t'i kërkuar ndjesë me shkrim ankuesit.

3. Për shkeljet që janë klasifikuar si shërbim i papërshtatshëm profesional, komiteti disiplinor jep njërën nga masat disiplinore të mëposhtme:

a) urdhër për t'i kërkuar ndjesë ankuesit publikisht;

b) rikthimin e pagesës ose anulimin e pagesës së shërbimit ndaj të përfaqësuarit;

c) pagimin e kompensimit për ankuesin deri në vlerën 100 000 lekë;

ç) urdhërimin e avokatit për të bërë trajnim vazhdues shtesë, përfshirë edhe trajnim në një fushë të veçantë të ligjit.

4. Vendimet e komitetit disiplinor, të cilat kanë marrë formë të prerë, përbëjnë tituj ekzekutivë. Rregullat për ekzekutimin e masave disiplinore, si dhe për mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre përcaktohen në statutin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 46

1. Komiteti Disiplinor i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, kryesisht ose me propozimin e dhomës së avokatëve, organeve gjyqësore, të prokurorisë, Ministrisë të Drejtësisë apo të personave të interesuar dhe në përputhje me nenin 44 të këtij ligji, ka autoritet të heqë lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit, kur vërtetohet një nga rastet e mëposhtme:

a) leja është lëshuar në kundërshtim me kushtet e parashikuara në nenin 25 të këtij ligji;

b) avokati ka përdorur dokumente të falsifikuara për të marrë lejen e ushtrimit të profesionit të avokatit;

- c) avokati vuan nga një sëmundje, sëmundje mendore ose dëmtime fizike, të cilat bëjnë të pamundur ushtrimin normal të profesionit;
- ç) avokati është deklaruar i falimentuar;
- d) avokati nuk ka paguar kontributin e anëtarësisë;
- dh) avokati ka shkelur rëndë ose në mënyrë të përsëritur rregullat për ushtrimin e profesionit të avokatit;
- e) avokati është dënuar nga gjykata për kryerjen e një vepre penale, me përjashtim të disa veprave penale që nuk kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore, sipas përcaktimeve në “Kodin e etikës së avokatit”.

2. Për avokatët e huaj, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 36, përveç rasteve të parashikuara më sipër në këtë nen, heqja e lejes së posaçme për ushtrimin e profesionit të avokatit në Republikën e Shqipërisë bëhet edhe në rastin kur atij i është hequr leja e ushtrimit të profesionit të avokatit në shtetin e tij.

Neni 46/1

1. Kur, në përfundim të procesit disiplinor, komiteti disiplinor e deklaron avokatin fajtor, përveç masave disiplinore të parashikuara në këtë ligj, mund të urdhërojë avokatin që:

- a) të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për zgjidhjen e problemit në fjalë;
- b) t'i kompensojë dëmin e shkaktuar ankuesit ose palëve të tjera të dëmtuara nga veprimet ose mosveprimet e tij, në masën që çmohet e drejtë nga komiteti disiplinor.

2. Komiteti disiplinor urdhëron avokatin e deklaruar fajtor të paguajë shpenzimet e palëve dhe të Dhomës Kombëtare të Avokatisë për përballimin e çështjes disiplinore kundër tij. Përllogaritja e shpenzimeve bëhet sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit Drejtues të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Neni 46/2

Dhoma Kombëtare e Avokatisë regjistron vendimet për caktimin e masave disiplinore në regjistrin e masave disiplinore të avokatëve dhe njofton për këto vendime Ministrinë e Drejtësisë.

Neni 46/3

Nëse masa për heqjen ose pezullimin e së drejtës për ushtrimin e profesionit të avokatit merret ndaj një avokati, sipas nenit 45 ose 46, avokati ka të drejtë, brenda 15 ditëve, të ankimojë vendimin para gjykatës. Ankimi nuk pezullon vendimin për heqjen ose pezullimin e së drejtës për të ushtruar profesionin e avokatit, me përjashtim të rasteve kur pezullimi urdhërohet nga gjykata.”.

Neni 15

Në nenin 48, pikat 2 dhe 3 shfuqizohen.

Neni 16

Pas nenit 48 shtohet neni 48/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 48/1

1. Kërkesat/ankesat për fillimin e procedimit disiplinor ndaj një avokati, që janë paraqitur përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe për të cilat nuk është dhënë vendim, evidentohen nga Kryetari i Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe i dërgohen Komisionerit të Ankimeve brenda 15 ditëve nga



emërimi i tij. Këto kërkesa/ankesa shqyrtohen sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe konsiderohen si të paraqitura në datën e depozitimit të tyre te Komisioneri i Ankimeve.

2. Dhoma Kombëtare e Avokatisë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, merr masat për ndryshimin e statutit të saj, si dhe miratimin e akteve nënligjore, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

3. Organet e reja disiplinore, të përcaktuara në këtë ligj, zgjidhen ose emërohen brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji. Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë i njoftojnë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, Dhomës Kombëtare të Avokatisë, përfaqësuesit e tyre në organet disiplinore.

4. Rregullat e përcaktuara në këtë ligj për programin e trajnimit të kandidatëve për avokatë dhe programin e trajnimit vazhdues të avokatëve fillojnë të zbatohen brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

5. Kërkesa për kontratën e sigurimit, e përcaktuar në pikën 11 të nenit 9, zbatohet që nga data 1 janar 2014.”.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7792, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

LIGJ

Nr. 92/2012

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 9723, DATË 3.5.2007 “PËR QENDRËN KOMBËTARE TË REGJISTRIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në pikën 2 të nenit 27 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar, fjalët “ose në kopje të njësuara me origjinalin” zëvendësohen me fjalët “ose në kopje të panjësuar me origjinalin, nën përgjegjësinë e plotë të aplikantit për vërtetësinë e akteve të marra si kopje të vërteta të origjinalit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 27.9.2012

**Shpallur me dekretin nr.7793, datë 15.10.2012 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.

Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2012, është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 16.10.2012
Doli nga shtypi më 17.10.2012

Tirazhi: 1200	Formati: 61x86/8
---------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2012

Çmimi 44 lekë